Also in our study like the risk of respiratory morbidity have increased compared with neonates delivered by vaginal delivery (37 weeks: odds ratio 4.3, 95% CI 3.3 to 6.3; 38 weeks: odds ratio 2.7, 95% CI 1.9 to 3.6 ; 39 weeks: odds ratio 2.1, 95% CI 1.6 to 3.0).

The risk of respiratory morbidity in early term infants (37 to 39 weeks) was confirmed by Tita and colleagues in an early 2009 study evaluating a cohort of 13,258 women who underwent an ECD <sup>23</sup> They noted that incidence of respiratory distress syndrome (RDS) was between 0.8 to 3.7% and significantly higher at the extremes of term gestation following elective repeat cesarean delivery. Similarly, the incidence of transient tachypnea of the newborn was 2.5% to 6.2% and also higher at the extremes of gestation, also the risk of admission to the neonatal ICU was from 2.3 to 1.5 at 38 weeks of gestational age.<sup>14</sup> In our study risk of admission at NICU have increased

in ECD in 37 weeks for approximately and at 38 weeks of gestational age the risk of admission at NICU have increased by 5.3. The authors suggested that iatrogenic respiratory morbidity could be reduced by performing ERCD after 39 weeks gestation.

V Zanardo and Co Neonatal respiratory morbidity risk (odds ratio, OR), including RDS and TTN, was significantly higher in the infant group delivered by elective caesarean delivery compared with vaginal delivery (OR 2.6; 95% CI: 1.35-5.9;  $p < 0.01$ ). While TTN risk in caesarean delivery was not increased (OR 1.19; 95% CI: 0.58-2.4;  $p > 0.05$ ), the RDS risk was significantly increased (OR 5.85; 95% CI: 2.27-32.4;  $p < 0.01$ ). This RDS risk is greatly increased in weeks 37 + 0 to 38 + 6 (OR 12.9; 95% CI: 3.57-35.53;  $p < 0.01$ ). After 39 + 0 wk, there was no significant difference in RDS risk.<sup>15</sup>

While our study revealed an increase in the incidence of Respiratory Morbidity for both RDS and TTN at ECD compared to vaginal births.

## Conclusion

The risk of neonatal respiratory morbidity after elective caesarean section in singletons born at University Obstetric Gynecologic Hospital “Queen Geraldine”, between 1 January 2011 and 31 December 2016 was twice to four times that after intended vaginal delivery within each gestational week from 37 to 39 weeks. When the risk of respiratory morbidity after elective caesarean section in each gestational week was compared with the risk after intended vaginal delivery at 40 weeks’ gestation, the relative risk decreased from seven times higher at 37 weeks to three times higher at 38 weeks, whereas the relative risk at 40 weeks was no longer statistically significant.

The careful planning of elective caesarean deliveries after week 39+ 0 could mean substantial cost savings and avoid the need to separate babies from their parents, which causes considerable anxiety to the family.

Although mortality from respiratory disease in our infants was zero, the affected babies suffered painful procedures with the related risks of complications and additional morbidity, negative effects on their physiological and biochemical responses to birth.

These early deliveries are associated with a preventable increase in neonatal morbidity and admissions to the

neonatal ICU, which carry a high economic cost. These findings support recommendations to delay elective delivery until 39 weeks of gestation and should be helpful in counseling.<sup>14</sup>

## References

- Morrison JJ, Rennie JM, Milton PJ. Neonatal respiratory morbidity and mode of delivery at term: influence of timing of elective caesarean section. *Br J Obstet Gynaecol*1995;102:101-6.
- Zanardo V, Simbi AK, Franzoi M, et al. Neonatal respiratory morbidity risk and mode of delivery at term: influence of timing of elective caesarean delivery. *Acta Paediatrica*. 2004;93:643.
- Bergholt T, Ostberg B, Legarth J, Weber T. Danish obstetricians’ personal preference and general attitude to elective cesarean section on maternal request: a nation-wide postal survey. *Acta Obstet Gynecol Scand*2004;83:262-6
- Villar J, Valladares E, Wojdyla D, Zavaleta N, Carroli G, Velazco A, et al. Caesarean delivery rates and pregnancy outcomes: the 2005 WHO global survey on maternal and perinatal health in Latin America. *Lancet*2006;367:1819-29
- Richardson BS, Czikk MJ, daSilva O, et al. The impact of labor at term on measures of neonatal outcome. *Am J Obstet Gynecol*. 2005;192:219.
- Hamilton BE, Martin JA, Ventura SJ. Births: preliminary data for 2006. *Natl vital stat rep*. 2007;56:1
- Scott JR. Cesarean delivery on request: where do we go from here? *Obstet Gynecol*2006;107:1222-3.
- Hannah ME. Planned elective cesarean section: a reasonable choice for some women? *CMAJ*2004;170:813-4
- ACOG Committee Opinion. Surgery and patient choice: the ethics of decision making. *Obstet Gynecol*2003;102(5 Pt 1):1101-6.
- Hansen AK, Wisborg K, Ulbjerg N, Henriksen TB. Elective caesarean section and respiratory morbidity in the term and near-term neonate. *Acta Obstet Gynecol Scand*2007;86:389-94.
- Jain L, Dudell GG. Respiratory transition in infants delivered by cesarean section. *Semin Perinatol*. 2006;30:296-304.
- Jain L, Eaton DC. Physiology of fetal lung fluid clearance and the effect of labor. *Semin Perinatol*. 2006;30:34-43.
- Hansen AK, Wisborg K, Ulbjerg N, et al. Risk of respiratory morbidity in term infants delivered by elective caesarean section: cohort study. *BMJ*. 2008;336:85-87.
- Tita AT, Landon MB, Spong CY, et al. Timing of elective repeat cesarean delivery at term and neonatal outcomes. *N Engl J Med*. 2009;360:111-120.
- Zanardo V, Simbi AK, Franzoi M, Solda G, Salvadori A, Trevisanuto D. Neonatal respiratory morbidity risk and mode of delivery at term: influence of timing of elective caesarean delivery. *Acta Paediatr* 2004;93:643-647

# DEPRESIONI POSTPARTAL DHE MULTIPARITETI

Florin Besimi<sup>1,2</sup>, Sani Bajrami<sup>1,2</sup>, Destan Haliti<sup>1,2</sup>, Bekim Ismaili<sup>1,2</sup>

<sup>1</sup>Departamenti për Obstetri dhe Gjinekologji, Spitali Klinik Tetovë

<sup>2</sup>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Tetovë

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 244-247

## ABSTRAKT

**HYRJE:** Termi "Depresioni postpartal" është një përmbledhje e disa çrregullimeve të gjendjes shpirtërore që shoqërojnë periudhën postnatale. Me rëndësi është të bëhet dallimi midis këtyre çrregullimeve, pasi që menaxhimi me to është i ndryshëm. Këto çrregullime të afektit, gershetohen njëra me tjetrën sa i përket simptomatologjisë, mirëpo ato kanë edhe veçori unike diferencuese. Ekzistojnë tri forma më të shpeshta të çrregullimeve afektive postpartale: mërzia maternale (baby blues), depresioni postnatal (postpartal) dhe psikoza puerperale (postpartale ose postnatale). Cdonjëra ndryshon për nga prevalenca, prezantimi klinik dhe menaxhimi. Suksesi i trajtimit të DPP do të rritet atëherë kur aktivitetet për rritje të vetëdijes dhe informimi i mjekëve dhe pacientëve të jete ne nivel te duhur. Arma më e fuqishme do të ishte ulja e përqindjes së lartë të nën diagnostikimit dhe rritja e përqindjes së grave që kërkojnë ndihmë mjekësore.

**QËLLIMI:** Studimi ka për qëllim të përcaktojë përqindjen e paraqitjes së depresionit postpartal te multiparat.

**MATERIALI DHE METODA:** Studimi është prospektiv, i realizuar në departamentin për obstetri-gjinekologji pranë Spitalit Klinik ne Tetovë, i realizuar në periudhën janar 2018 – nëntorë 2018, në kuadër të së cilit janë analizuar 323 raste shtatzënie, të cilat kanë lindur tre e më tepër fëmijë nga gjithësejt 1326 lindje.

**REZULTATET:** Nga gjithësejt 1326 lindje të realizuara në departamentin për obstetri dhe gjinekologji, për analizë janë trajtuar 323 gra shtatzëna multipara (24,35 %) që kanë patur tre e më tepër lindje. Nga 323 rastet 260 prej tyre kanë lindur fëmijë të 3'të, në 50 raste kanë lindur fëmijë të 4'të, në 9 raste kanë lindur fëmijë të 5'të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 6'të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 7'të. Nga këto lindje të shumëfishta të realizuara nrenda periudhës një vjeçare në departamentin për obstetri-gjinekologji pranë Spitalit Klinik Tetovë, te 15 raste ose (4,64 %) pas lindjes është diagnostikuar depresioni postpartal.

**PËRFUNDIMI:** Nga rezultatet e fituara mund të konkludojmë që depresioni postpartal është prezent në përqindje të konsiderueshme respektivisht 1,13 % nga numri i përgjithshëm i lindjeve në rajonin e Tetovës. Gjithashtu përqindja e lindjeve të shumëfishta është akoma një përqindje serioze, që paraqet edhe një nga shkaqet kryesore të neurozës postpartale.

**DISKUTIMI:** Depresioni postpartal në botë paraqitet tek 10 – 15% të grave, derisa 0.1–0.2% e grave përjetojnë formën më të rëndë, atë të psikozës puerperale. Në studimin tonë paraqitja e depresionit në vlera 1,13 % tregon poashtu një përqindje serioze, mirëpo ngelet për tu diskutuar përqindja e pacienteve të pa diagnostifikuar.

Fjalë kyç: depresioni postpartal, lindja e shumëfishtë

## HYRJE

Termi "Depresioni postpartal" (DPP) është një përmbledhje e disa çrregullimeve të gjendjes shpirtërore që shoqërojnë periudhën postnatale. Është me rëndësi të bëhet dallimi midis këtyre çrregullimeve, pasi që menaxhimi i tyre ndryshon. Këto çrregullime të afektit, gershetohen njëra me tjetrën sa i përket simptomatologjisë, mirëpo ato kanë edhe veçori unike diferencuese[1].

Ekzistojnë tri forma më të shpeshta të çrregullimeve

afektive postpartale: mërzia maternale (baby blues), depresioni postnatal (postpartal) dhe psikoza puerperale (postpartale ose postnatale), ku çdonjëra ndryshon për nga prevalenca, prezantimi klinik dhe menaxhimi[2]. Gjatë periudhës postpartale 85% e grave përjetojnë ndonjë lloj çrregullimi të afektit. Depresioni postpartal paraqitet te 10 – 15% të grave, derisa 0.1–0.2% e grave përjetojnë formën më të rëndë, atë të psikozës puerperale[3]. DPP aktualisht përcaktohet në përputhje me kriteret e Manualit Diagnostik dhe Statistikorë të çrregullimeve



mentale (DSM-IV) për çrregullime madhore depressive, ku së paku katër nga simptomat vijuese përjetohen gati se çdo ditë për të paktën dy javë: insomnia, hypersomnia, agjitimi psiko motor ose retardimi, lodhja, ndryshime në oreks, ndjenja të pavlefshmërisë, ndjenja e fajit, përqendrim i zvogëluar dhe mendime suicide. Pacienti po ashtu duhet të ketë ndjenja depressive në/ose humbje të interesit ose kënaqësisë në aktivitetet e përditshme, që kanë filluar brenda katër javësh që nga lindja [4] DPP zakonisht fillon 1 - 12 muaj pas lindjes. Mekanizmi i vërtetë i depresionit postpartal nuk është i njohur plotësisht. Shumica e shkenctarëve besojnë që DPP është një kompleks bio-psiko-social. Aspektit biologjik i sëmundjes, bazohet në ndryshimin e nivelit të hormoneve estrogenit dhe progesteronit gjatë shtatzanisë dhe rrënia e nivelit të këtyre hormoneve pas lindjes të luaj rol kyç. Aspekti psikologjik merr parasysh vetëbesimin e ulur, pesimizmin si veçori e personalitetit, strategjitë e dobëta për menaxhimin e stresit, si dhe reagimet e ndryshme emocionale. Aspekti social asocohet me kushtet ekzistenciale të gruas shtatzanë, mbështetjen e partnerit si dhe nivelin edukativ.

Menaxhimi i DPP-se duhet të jetë i individualizuar për çdo pacient. Trajtimi në të shumtën e rasteve arrihet në mënyrë ambulatorë, mirëpo nëse rrezikohe jeta e nënës ose e foshnjës atëherë nevojitet hospitalizimi. Baza e menaxhimit ambulator përfshin psikoterapinë dhe farmakoterapinë, deri sa rastet e rënda psikotike kërkojnë përfshirjen e barnave antikonvulziv. Trajtimet alternative si fototerapia, akupunktura, ushtrimet dhe masazha po ashtu duhet të merren në konsideratë. Të dhënat sa i përket përdorimit të antidepressantëve triciklik (ATC), fluoxetine, sertraline dhe paroxetine gjatë gjdhënies janë inkurajuese dhe niveli i antidepressantëve në serumit e foshnjës janë shumë të ulta ose të pa detektueshme. Gratë që trajtohen me acid valproik ose karbamazepine duhet të shmangen gjdhënies, për shkak të hepatoksitetit tek foshnjat.[5] Suksesi i trajtimit të DPP-se do të rritet atëherë kur aktivitetet për rritje të vetëdijes dhe informini i mjekëve dhe pacientëve të jete në nivel të duhur. Arma më e fuqishme do të ishte ulja e përqindjes së lartë të nën diagnostifikimit dhe rritja e përqindjes së grave që kërkojnë ndihmë mjekësore. Llogaritë që 50% e rasteve me DPP kalojnë pa u diagnostifikuar. Më së shumti diagnostikimi bëhet nga mjeku i praktikës primare (41,3%), pastaj nga gjinekologu/obstetri (30.7%), si dhe nga ndonjë ekspert i shëndetit mental (13.0%).[6]. Është imperative që mjeku i praktikës primare të familjarizohet me simptomat, faktorët e

rrezikut si dhe metodat e skrinitimit. Njëra ndër metodat më të suksesshme të skrinitimit për DPP është pyetëtori i Edinburg-ut, Edinburgh Postpartum Depression Scale (EPDS), ku një rezultat  $\geq 9$  identifikon 90% të nënave me DPP.[7] Çrregullimet psikiatrike pas lindjes paraqesin një përqindje të konsiderueshme shëndetësore në komunitet për shkak të prevalencës së tyre dhe ndikimit të tyre në marrëdhëniet prind-fëmijë dhe tek çifti bashkëshortor [1].

## QËLLIMI

Studimi ka për qëllim të përcaktojë përqindjen e paraqitjes së depresionit postpartal te multiparat në rajonin e Tetovës.

## MATERIALI DHE METODA

Studimi është prospektiv i realizuar, në departamentin për obstetri-gjinekologji pranë Spitalit Klinik në Tetovë, i realizuar në periudhën janar 2018 - nëntorë 2018. Janë analizuar 323 raste të grave shtatzëna të cilat kanë lindur tre e më tepër fëmijë nga gjithësejt 1326 lindje. Të dhënat janë marrë nga kartelat e lindjes dhe nga të dhënat kthesë të marra nga mjekët amë të pacientëve të cilët kanë kërkuar ndihmën e tyre dhe më pastaj kanë vazhduar kontrollet tek psikologu ose neurologu. Janë marre në pyetje multiparat për paraqitje të ndryshimeve psikike në periudhën postpartale.

## REZULTATET

Nga gjithësejt 1326 lindje të realizuara në departamentin për obsterti dhe gjinekologji janë analizuar 323 gra shtatzëna ose (24,35 %) që kanë patur lindje të shumëfishta respektivisht tre ose më tepër lindje, (Tabela 1.grafikoni 1). Nga 323 rastet me lindje të shumëfishtë, në 260 raste kanë lindur fëmijë të 3-të, në 50 raste kanë lindur fëmijë të 4-të, në 9 raste kanë lindur fëmijë të 5'të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 6'të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 7'të, (Shih. grafikoni 2). Nga 323 lindje të shumëfishta të realizuara në periudhë 10 mujore në departamentin për obstetri- gjinekologji pranë Spitalit Klinik Tetovë në 15 ose (4,64 %) raste kemi paraqitje të neurozes postpartale (grafikoni 3). Nga 1326 lindje të përgjithshme rezulton që 15 ose (1,13 %) raste janë të diagnostikuara me neurozë postpartale, (Shih. grafikoni 4). Sipas vendbanimit nga 15 raste me neurozë postpartale rezulton që 9 gra ose (60%) jetonin në fshat dhe 6 gra ose (40 %) jetonin në qytet, (Tabela 2. grafikoni 5).

Tabela 1.


Paraqitje tabelare e te gjithe shtatzenave	
Gjithësejt	1326 lindje
Me lindje të shumëfishtë	323 (24,35%)
Me paraqitje të neurozës postpartale	15 (1,13%)

Tabela 2.


Ndarje tabelare sipas vendbanimit	
Fshat	9 (60%)
Qytet	6 (40%)
Gjithësejt paciente me neurozë postpartale	15 (100%)

Tabela 2. Ndarja sipas vendbanimit fshat/qytet e nënave te diagnostifikuara me neurozë postpartale ..


Nga gjithësejt 1326 lindje të realizuara në departamentin për obsterti dhe gjinekologji pranë Spitalit Klinik Tetovë janë analizuar 323 ose (24,35 %) shtatzëna që kanë patur lindje të shumëfishta, grafikoni 1.




Grafikon 1. Ndarje sipas numrit të lindjeve për periudhë 10 mujore. Nga të analizuar 323 ose (24,35 %) shtatzëna që kanë patur lindje të shumëfishta, nga ato në 260 raste kanë lindur fëmijë të 3-të, në 50 raste kanë lindur fëmijë të 4-të, në 9 raste kanë lindur fëmijë të 5-të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 6-të, në 2 raste kanë lindur fëmijë të 7-të, grafikoni 2.




Grafikon 2. Ndarje e sipas lindjeve të shumëfishta. Nga 323 lindje të shumëfishta të realizuara në periudhë 10 mujore në departamentin për obstetri- gjinekologji pranë Spitalit Klinik Tetovë në 15 ose (4,64 %) raste kemi paraqitje të depresionit postpartal grafikoni 3.



Grafikoni 3. Ndarja sipas paraqitjes së neurozës postpartale tek gratë me lindje të shumëfishta.



Grafikoni 4. Paraqitja grafike sipas përqindjes së sëmundjes në raport me numrin total të lindj



Grafikon 5. Paraqitje grafike e pacientet të cilat u diagnostikuan me neurozë postpartale sipas vendbanimit fshat/qytet.

## PËRFUNDIMI

Nga rezultatet e mara mund të konkludojmë që:

1. Neuroza postpartale është prezente në përqindje të konsiderueshëm respektivisht 1,13% nga numri i përgjithshëm i lindjeve në rajonin e Tetovës.
2. Gjithashtu përqindja e lindjeve të shumëfishta është akoma një përqindje serioze, që paraqet edhe një nga shkaqet kryesore të neurozës postpartale.
3. Raporti i vendbanimit fshat/qytet në raport 60:40 tregon që jeta patriarkale në fshat akoma ngelet një faktor i raporteve jo të shëndosha në raportet burrë/grua.
4. Mosha mesatare 26,4 vjeç poashtu tregon që këta shtatzëna si pasojë e lindjeve të shumta kanë përjetuar një rrënie serioze të shëndetit të tyre të përgjithshme dhe në një farë forme e kanë thelluar gjendjen e tyre psikike..

## DISKUTIMI

Depresioni postpartal në botë përfshinë 10 - 15% të grave, derisa 0.1-0.2% e grave përfshijnë formën më të rëndë, atë të psikozës puerperale. Në studimin tonë paraqitja e depresionit në vlera 1,13 % nga të gjithë lindjet per periudhën njevjecare tregon poashtu një përqindje serioze. Vlen për tu diskutuar se vallë a paraqiten të gjithë gratë me nevojë për konsultime tek mjeku i tyre amë ose mjekë të profiëve përkatëse. Në botë llogaritet që diku 50% e rasteve me DPP kalojnë pa u diagnostikuar. Tek ne ngelet për tu diskutuar përqindja e grave të pa diagnostikuara. Pa diskutim që lindjet e shumta ndikojnë në paraqitjen direkte të neurosës postpartale, pastaj kushtet ekonomike e bejnë akoma më të vështirë gjendjen e grave të cilat realizojnë më shumë lindje. Menaxhimi DPP duhet të jetë i individualizuar për çdo pacient. Trajtimi në të shumtën e rasteve arrihet në mënyrë ambulatorë, mirëpo nëse rrezikohet jeta e nënës ose e foshnjës, atëherë nevojitet hospitalizimi. Ngelet që shoqatat joqeveritare asociacionet e ndryshme të stimulojnë ndërgjegjësimin e nënave të reja në lidhje me planifikimin familjar të tyre.

## REFERENCA

1. Perfetti, Jennifer, Roseanne Clark, and Capri-Mara Fillmore. "Postpartum Depression: Identification, screening, and treatment." *Wisconsin Medical Journal*. 2004; 103(6):56-63.

2. Robertson, E., Celasun, N., and Stewart, D.E. (2003). Risk factors for postpartum depression. In Stewart, D.E., Robertson, E., Dennis, C.-L., Grace, S.L., & Wallington, T. (2003). *Postpartum depression: Literature review of risk factors and interventions*.
3. Kendell RE, Chalmers JC, Platz C. Epidemiology of puerperal psychoses. *Br J Psychiatry*. 1987 May; 150:662-73.
4. Moses-Kolko, Eydie and Erika Kraus Roth. "Antepartum and Postpartum Depression: Healthy mom, healthy baby." *Journal of the American Medical Women's Association*. 2004; 59: 181-91.
5. ACOG Practice Bulletin: Clinical management guidelines for obstetrician-gynecologists number 92, April 2009 (replaces practice bulletin number 87, November 2007). Use of psychiatric medications during pregnancy and lactation. *Obstet Gynecol*. 2008 Apr; 11(4):1001-20.
6. Dietz, Patricia M., Selvi B. Williams, William M. Callaghan, Donald J. Bachman, Evelyn P. Whitlock, and Mark C. Hornbrook. "Clinically Identified Maternal Depression Before, During, and After Pregnancies Ending in Live Births." *American Journal of Psychiatry*. 2007; 164(10): 1515-20.
7. ACOG Practice Bulletin: Clinical management guidelines for obstetrician-gynecologists number 92, April 2008 (replaces practice bulletin number 87, November 2007). Use of psychiatric medications during pregnancy and lactation. *Obstet Gynecol*. 2008 Apr; 11(4):1001-20.

## ABSTRACT

**INTRODUCTION:** The term "Depression Postpartal" is like an umbrella, which summarizes some of the mood disorders associated with postnatal periods. It is vital to distinguish between these disorders, as their management varies. These affective disorders overlap each other with regard to symptomatology, but they also have a unique differentiating feature. There are three most common forms of postpartum affective disorders: baby blues, postnatal depression (postpartal) and puerperal psychiatry (postpartum or postnatal), each ranging from prevalence, clinical presentation, and management. The DPP treatment success will increase when awareness-raising campaigns and informing doctors and patients overcome the social stigma. The most powerful weapon would be to lower the high percentage of under diagnosis and increase the percentage of women seeking medical help. **PURPOSE:** The paper aims to determine the ratio of multiple births and postpartum depression. **MATERIAL AND METHODS:** The work is prospective, realized in the Department of Obstetrics and Gynecology at the Clinical Hospital Tetovo, conducted in January 2018 - November 2018, were analyzed 323 pregnant women who were born three or more children out of all 1326 births, out of which 15 women had postpartum neurosis, with an average age of 26.4 years. **RESULTS:** Out of all 1326 births realized in the department for obstetrics and gynecology are 323 or 24.35% of pregnant women have had multiple births, respectively, three or more births. Out of the 323 cases in 260 cases were born 3 children, in 50 cases were born 4 children, in 9 cases children were born at 5, in 2 cases were born 6 children, in 2 cases 7 children were born, of these multiple births realized in one year in the obstet's department gynecology at the Clinical Tetovo Hospital in 15 or (1,13%) postnatal cases are diagnosed with postpartum neurosis. **CONCLUSION:** From the results obtained we can conclude that postpartal neurosis is present in significant percentage respectively 1,13 % of the total number of births in the Tetovo region. Also, the percentage of multiple births is still a serious percentage, which is also one of the main causes of postpartum neurosis. **DISCUSSION:** Postpartum depression affects 10-15% of women, while 0.1-0.2% of women experience the worst form of puerperal psychiatry, and in our study the emergence of neuroses at 1.13% indicates a serious percentage,

Key words: multiple births, postpartal

## GIHT, DIAGNOZA DHE TRAJTIMI

Bekim Ismaili<sup>1,2</sup>, Nevzat Elezi<sup>2</sup>, Ilber Besimi<sup>2,3</sup>, Katarina Stavric<sup>4</sup>

<sup>1</sup>IPSH Dr Bekim, Tetovë, Maqedoni

<sup>2</sup>UT, Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë, Tetovë, Maqedoni

<sup>3</sup>Spitali Klinik Tetovë

<sup>4</sup>Klinika Universitare “Nënë Tereza” - Shkup

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 248-250

### ABSTRAKT

Hyrje: Artriti urik është sëmundje që shkaktohet nga çrregullimi i metabolizmit të acidit urik në organizëm, depozitimit të kristaleve të tij në inde dhe shfaqjen e episodeve inflamatore në artikulacione. Incidenca e gihtit në popullatë është rreth 0,20-0,35 në 1000 banor, kurse prevalenca 1,6-13,6 në 1000 banor. Diagnoza e hershme dhe mjekimi bashkëkohor dhe adekuat japin mundësi që të ndikojmë në ecurinë natyrore të gishtit. Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi qëndron në diagnozën e hershme dhe trajtimin bashkëkohor të sëmurëve me artrit urik. Materiali dhe metoda: Në studim janë përfshirë 15 të sëmurë me artrit urik, që janë trajtuar në Ordinancën e mjekësisë familjare 8» Dr Bekim», në periudhën 2017 – 2010. Rezultatet: Në grupin tonë 13 ose 86,6% ishin meshkuj dhe 2 ose 13,4% femra, me moshë mesatare 46.8 vjeç. Të gjithë të sëmurët kishin artrit urik akut, formën monoartikulare, të lokalizuar në gishtin e madh të këmbës. Përfundim: Diagnoza e hershme dhe mjekimi bashkëkohor kanë për qëllime qetsimin e simptomave të artritit akut dhe prevencën e ndryshimeve strukturale të nyjave.

Fjalë kyç: Gihti, hiperuratemia, artropati urike akute

### Hyrje

Gihti mund të jetë parësor dhe dytësor. Gihti parësor karakterizohet me çrregullimin e lindur të metabolizmit të purinave me natyrë enzimatisë, që rezulton me shfaqje të hiperuricemisë së përhershme. Gihti parësor është sëmundje e meshkujve, kurse femrat, praktikisht sëmurën në menopauzë. Te meshkujt gihti shfaqet pas moshës 30 vjeçare, më shpesh ndërmjet moshave 40-60 vjeç. Te gihti dytësorë shkak i hiperuricemisë janë sëmundjet mieloproliferastive të gjakut, sëmundjet e veshkave, saliuaretikët, hipoparatiroidizmi, miksedema, etj.

Përqëndrimi i urateve në gjak është 357 mmol/l ose 6 mg% për meshkujt dhe 327 mmol/l ose 5,5% për femrat. Kur përqëndrimi i acidit urik në gjak dhe në lëngun indor e kalon kufirin e tretshmërisë, formhen kristale të mononatrium urat dehidratit, të cilat janë shkaktarë të artritit akut (5, 7).

Ecurinë natyrore të sëmundjes e karakterizojnë katër stadi: hiperuricemia asimptomatisë, artriti akut, periudha interkritike dhe shfaqja e tofave (6).

Artriti te gihti i ka këto veçori: fillimi akut, zakonisht

natën, zhvillimi i shpejtë i reaksionit inflamator; simptomat e dhimbjes dhe ndieshmëria e nyjave janë mjaft të shprehura; lëkura merr ngjyrë të kaltër dhe është e thatë; manifestohet në formë të monoartritit, me lokalizim karakteristik te mbi 75% në gishtin e madh të këmbës; artriti zgjatë disa ditë, rrallë herë deri në 3 javë dhe me qetësimin e inflamacionit shfaqet remisio i plotë klinik dhe funksional i nyjes.

Faktorët precipitues që ndikojnë në shfaqjen e artriti akut janë: lëndimi, intervenimi kirurgjik, stresi psikik, kosumimi i sasive të mëdha të ushqimit të pasur me purine dhe kalori, alkooli, salicilatet, diuretikët tiazid, ciklosporina, urikozurikët dhe urikosupresorët, etj.

Mjekimi i gihtit varet nga faza e sëmundjes. Mjekimi është higjieno-dijetik dhe medikamentoz. Prej medikamenteve përdoren antiinflamatorët josteroid, urikozurikët dhe urikodepresorët (1).

### Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi qëndron në diagnozën e hershme dhe trajtimin bashkëkohor të sëmurëve me artrit urik.

## Materiali dhe Metoda

Në studim janë përfshirë 15 të sëmurë me artrit urik akut, që janë trajtuar në Ordinancën e mjeksisë familjare « Dr Bekim», në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2018.

Diagnoza e gihtit akut është bazuar në anamnezën, ekzaminimin klinik dhe biokimik dhe ekzaminimin radiologjik.

## Rezultatet

Në tabelën 1 është paraqitur frekuenca e simptomave të gihtit sipas gjinisë.

Tabela 1.  
Frekuenca e simptomave të gihtit sipas gjinisë

GIHT	Përqindja		
	M	F	Total
Pacientë	86.67	13.33	100.00
Dhimbje	86.67	13.33	100.00
Ajtje	66.67	13.33	80.00
Skuqje	66.67	13.33	80.00
Tem. lokale	46.67	13.33	60.00
Tem- sistemore	26.67	0.00	26.67
Uremi	80.00	13.33	93.33
Leukocitozë	66.67	13.33	80.00
Sedimetacion	60.00	6.67	66.67

Në tabelën 2 është paraqitur frekuenca e simptomave të gihtit sipas moshës.

Tabela 2.  
Frekuenca e simptomave të gihtit sipas moshës

GIHT	20 - 30		31 - 40		41 - 50		51 - 60		>60		Gjithsejt		
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	Total
Pacientë	1		2		5	1	3	1	2		13	2	15
Dhimbje	1		2		5	1	3	1	2		13	2	15
Ajtje			2		4	1	3	1	1		10	2	12
Skuqje	1		2		5	1	2	1			10	2	12
T. lokale			2		2	1	2	1	1		7	2	9
T- sistemore					3		1				4	0	4
Uremi	1		2		5	1	3	1	1		12	2	14
Leukocitozë	1		2		4	1	2	1	1		10	2	12
Sedimetacion					5	1	3		1		9	1	10



Fig. 1. Podagra



Fig. 2 Tofe në burzën olecrani

## Diskutimi

Diagnoza e hershme dhe mjekimi bashkëkohor i gihtit ndikojnë në ndërrimin e ecurisë natyrore të sëmundjes dhe e parandalon shfaqjen e recidivave të artritit, tofeve, artropatisë kronike dhe nefropatisë urike. Po ashtu, diagnoza e hershme dhe mjekimi adekuat mund të parandalojnë ose të ngadalsojnë edhe evoluimin e çrregullimeve kardiovaskulare, siç janë: hipertensioni arterial dhe vaskulopatia aterosklerotike.

Mjekimi bashkëkohor i gihtit ka dy qëllime. I pari, zbutjen e simptomave të artritit akut me anë të barnave bashkëkohore. Artriti urik akut është artriti më dramatik në urgjencën mjekësore, zgjatë 1-3 dite. Qetësohet shpejt me antireumatik josteroid, si psh. me capsula Indometacin a 25 mg çdo gjashtë orë nga dy kapsula 2-3 ditë, ose me Kolhicin, në fillim jepen dy tablet 0,5 mg, kurse pastaj çdo dy orë nga një tablet deri në qetësimin e simptomave. Qëllimi i dytë, qëndron në normalizimin dhe kontrollën e hiperuricemise (hiperuratemisë),

respektivisht prevenimin e recidivave të artritetit urik. Aplikimi racional dhe i baraspeshuar i urikozurikëve dhe i urikosupresorëve e ndryshon evolucionin dhe prognozën e gihtit (2, 3, 5, 6, 7).

### Përfundimi

Artriti urik akut është gjendja më dramatike në urgjencën mjekësore;

Diagnoza e hershme dhe mjekimi racional i gihtit e ndërron ecurinë natyrore dhe prognozën e sëmundjes.

Në diagnozën diferenciale duhet të dallohet nga chondrocalcinoza (pseudogihti), artriti psoriatik, sëmundja Reiter, artriti infektioz, flegrona, etj.

Mjekimi higjieno dijetetik ka për qëllim korrigjimin e të gjithë faktorëve që ndikojnë në rritjen e përqendrimit të acidit urik.

### BIBLIOGRAFIA

1. Coleman K, Norris S, Weston A, et al. NHMRC additional levels of evidence and grades for recommendations for developers of guidelines: Pilot program 2005-2007. Canberra: NHMRC, 2005
2. Joanna Briggs Institute Data Extraction Tool. Available at [www.joannabriggs.edu.au/isearch/index.php](http://www.joannabriggs.edu.au/isearch/index.php). [Accessed 2007]
3. Platt, AF (2008). Evidence-Based Medicine for PDAs: A Guide for Practice. Jones and Bartlett Publishers. pp. 80–82. WebMD Buys eMedicine
4. Combe B, Landewé R, Lukas C, et al. EULAR recommendations for the management of early arthritis: Report of a task force of the European Standing Committee for International Clinical Studies Including Therapeutics (ESCSIT). *Ann Rheum Diseases* 2007;66:34–45. (Pre-view published online 2006).
5. National Health and Medical Research Council. Making decisions about tests and treatments: Principles for better communication between healthcare consumers and healthcare professionals. Canberra: NHMRC, 2005

## GIHT, DIAGNOSIS AND TREATMENT

Bekim Ismaili<sup>1,2</sup>, Nevzat Elezi<sup>2</sup>, Ilber Besimi<sup>2,3</sup>

### SUMMARY

Introduction: uric arthritis is a disease caused by a disorder of uric acid metabolism in the body, depositing crystals of it in tissue and the appearance of inflammatory episodes in the joints. Giht incidence in the population is about 0.20 to 0.35 in 1000 per capita, while the prevalence from 1.6 to 13.6 per 1000 inhabitants. Early diagnosis and modern treatment and provide adequate opportunity to influence the natural progress of the giht. Purpose: The purpose of this paper lies in early diagnosis and modern treatment of patients with uric arthritis. Material and methods: The study included 15 patients with uric arthritis who treated at Private medical institution for familiar medicine “ Dr Bekim” in Tetovo, in the period 2017 to 2018. Results: In our group of 13 or 86.6% are males and 2 females or 13.4%, with a mean age of 46.8 years. All the patients had acute uric arthritis, monoarthricular form, located in the thumb of the foot. Conclusion: Early diagnosis and treatment have for contemporary calm the symptoms of acute arthritis and prevention of structural changes of joints.

Key words: Giht, Hiperuremy, acute uric arthropaty,

# KORELACIONI I TRAJTIMIT TË ANEMISË SIDEROPENIKE ME FERRO(III)-PROTEINSUCCINYLAT DHE ME FERRO SUCROSOMIAL

Sani Bajrami<sup>1</sup>, Anita Sinani<sup>1</sup>, Florin Besimi<sup>1</sup>, Sanije Berisha<sup>1</sup>

<sup>1</sup>IPSH.PEDIATRIKA, Tetovë

<sup>1</sup>Fakulteti i Mjekësisë, Tetovë

<sup>1</sup>Departamenti për Obstetri -Gjinekologji, Spitali Klinik -Tetovë

<sup>1</sup>Departamenti për Biokimi Klinike, Spitali Klinik -Tetovë

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 251-256

## ABSTRAKT

**HYRJE:** Me anemi nënkuptojmë numrin e zvogëluar të eritrociteve ose sasisë së zvogëluar të Hgb-së ose të njërës dhe të tjetrës në të njëjtën kohë, nën vlerat referente për moshë. Hekuri është metal që merret me ushqimet dhe është i domosdoshëm për sintezën e hemoglobinës dhe ngopjen e depove të saja. Gjatë periudhave të ndryshme të jetës shtohen edhe nevojat ditore për hekur si në foshnjat, dhe në qoftë se kjo nevojë nuk plotësohet atëherë zhillohet anemia hipokrome.

**QËLLIMI:** Ky punim ka për qëllim të përcaktojë raportin kohor dhe rezultatet e trajtimit të anemive ferodeficitare me hekur (III)-proteinsuccinylat dhe ferrosucrosomial.

**MATERIALI DHE METODAT:** Punimi është prospektiv i realizuar gjatë skringut të anemisë tek infantët, në IPSH - PEDIATRIKA në Tetovë, dhe laboratorin klinik pranë Spitalit Klinik Tetovë, janë analizuar 76 infanë të diagnostikuar me anemi ferodeficitare, të moshës 1-12 muaj, të cilët janë mjekuar në periudhën janar – qershor të 2018-tës. Të moshës mesatare 7,4 muajshe, ndarja sipas gjinisë ka qenë si vijon: 47 infante të gjinisë femrore, 29 të gjinisë mashkullore.

**REZULTATET:** Janë analizuar rezultatet e marra në fillim dhe pas trajtimit me terapi antianemike në të dy grupet, respektivisht grupi i cili është trajtuar me hekur sucrosomial ka treguar përmirësim të dukshëm të parametrave si janë hgb, hct, MCV dhe Fe ++ pas përdorimit të terapisë brenda 1 muaji, ndërkaq grupi i pacientëve të trajtuar me protein succinylat ka patur përmirësim dukshëm më të dobët sesa grupi i trajtuar me ferrosucrosomial.

**PËRFUNDIMI:** Trajtimi me ferro sucrosomial është treguar më efektiv te përqindja më e madhe e pacientëve me anemi ferodeficitare, respektivisht parametrat siç janë hgbhct MCV dhe Fe ++ kanë rritje më të lartë në grupin e trajtuar me ferro sucrosomiale, për periudhën 1 mujore.

**DISKUTIMI:** Mënyra e të ushqyerit tek infantët është shumë e rëndësishme dhe ndikon në rezultatet e trajtimit të anemisë ferodeficitare, rekomandohen produktet ushqimore të pasura me hekur dhe përdorimin e terapisë e cila shkurton periudhën e trajtimit dhe nuk ka efekte anësore.

Fjalë kyç: anemia ferodeficitare, trajtimi.

## HYRJE

Me anemi nënkuptojmë numrin e zvogëluar të eritrociteve ose sasisë së zvogëluar të Hgb-së ose të njërës dhe të tjetrës në të njëjtën kohë, nën vlerat referente për moshë.

Anemia mund të shkaktohet nga faktor të ndryshëm dhe është sëmundja më e shpeshtë e gjakut në fëmijëri.

Shfaqet në 30% të popullatës në botë dhe është njëra prej problemeve më të mëdha shëndetësore, karakterizohet me ndërrimin e madhësisë dhe koloritetit të qelizave

të kuqe të gjakut, është sëmundje e cila zvogëlon oksiforitetin e gjakut.

Për shkak të oksiforitetit të zvogëluar të gjakut pason hipoksia e indeve.

Hekuri është metal që merret me ushqimet dhe është i domosdoshëm për sintezën e hemoglobinës dhe ngopjen e depove të tij.

Përthithja e hekurit të ushqimeve dhe e preparateve të tij bëhet në duoden dhe në pjesën e sipërme të zorrës së hollë.

Hekuri gjendet në formë dy dhe tri valente por në zorrë thithet vetëm hekuri dyvalentë, pra forma trivalente kthehet në dyvalente në prani të acidit klorhidrik.

Në njerezit normal vetëm 5-10 % e sasisë së tij të dietës thithet, ndërsa në të sëmurët me anemi hipokrome sasia e thithur arrinë deri në 20%.

Prania në stomak e ushqimeve të pasura me kripëra të fosforit dhe kalciumit e ulin sasinë e hekurit që duhet të thithet.

Në organizem rreth 2/3 e sasisë së hekurit gjendet në hemoglobine, 1/4 në depot e saja (palcën e kockës, melci, shpretkë, në formë të feritines dhe hemosiderinës, rreth 3% në mioglobinë.

Gjatë periudhave të ndryshme të jetës shtohen edhe nevojat ditore për hekur si në foshnjat, dhe në qoftë se kjo nevojë nuk plotësohet atëherë zhillohet anemia hipokrome.[10][11]

Hekuri është oligoelement që merr pjesë në shumë procese metabolike si: bartja e oksigjenit, bartja e elektroneve, metabolizmin e katekolaminave, sintezën e ARN-së, rregullatori i gjeneve etj.[1][3]

Nevoja për hekur është e rritur gjatë zhvillimit të fëmijës, në mënyrë që furnizimi i duhur i këtij minerali të jetë i rëndësishëm për të inkurajuar një rritje të shëndetshme[5][6].

Është konstatuar se anemia më rrallë është shfaqur te fëmijët e ushqyer me gji, më shpesh te ata të ushqyer me qumësht të adaptuar sipas formulës, ndërsa dukshëm më shpesh te fëmijët e ushqyer me qumësht lope[7].

Hekuri në fero socrosomial gjendet brenda një membrane fosfolipidike sucrosomiale®, që do të thotë se është shumë më biosolubile, kjo teknologji parandalon plotësisht efektet anësore të lidhura me hekurin.

Diagnoza caktohet në bazë të manifestimeve klinike dhe të analizave laboratorike, në atë rast eritrocitet janë të vogla (mikrocite), përqëndrimi i hemoglobinës gjithmonë është i zvogëluar, prandaj eritrocitet ngjyrosen dobët (hipokromi), hematokriti është i zvogëluar, vëllimi mesatar i eritoriteve (MCV) zvogëlohet nën 60 fL, përqëndrimi i hekurit në serum është i zvogëluar, ndërsa kapaciteti i lidhjes të hekurit është i rritur, përqëndrimi i feritines në serum është i zvogëluar.

Manifestimet klinike të anemisë mund të jenë të lehta apo të rënda dhe janë proporcionale me sasinë e zvogëluar të Hgb-së.

Këto manifestime klinike janë si pasojë e hipoksisë së indeve: zbehje e lëkurës dhe mukozave, dhimbje koke, refuzimi i ushqimit, shtim të ngadalësuar të peshës, mungesë oreksi, iritabilitet, etj[2][4][8].

Parimet e mjekimit të anemisë sideropenike janë: dhënia e preparateve të hekurit, të cilat duhet të bëhen gradualisht, duhet të fillohet me doza të vogla deri te doza e duhur terapeutike, më së miri absorbohet si hekur trevalentë i cili jonizohet mirë dhe absorbohet si ferosulfat ose feroglukonat, preparatet e hekurit duhet të merren me acid askorbik gjë që ndihmon absorbimin e tij dhe ndalon oksidimin e hekurit dyalentë (fero++ne feri+++), gjithashtu lehtëson absorbimin e hekurit nga trakti tretës në gjak, mjekimi zgjatë 3 muaj.[9]

## QËLLIMI:

Punimi ka për qëllim të përcaktojë raportin kohor dhe rezultatet e trajtimit të anemive ferodeficitare me hekur (III)-proteinsuccinylat dhe ferrosucrosomial.

## MATERIALI DHE METODAT

Punimi është prospektiv i realizuar gjatë skringut të anemisë tek infantët, në IPSH PEDIATRIKA në Tetovë, dhe laboratorin klinik pranë Spitalit Klinik në Tetovë, janë analizuar 76 infantë të diagnostikuar me anemi ferodeficitare, të moshës 1-12 muaj, që janë mjekuar në periudhën janar - qershor të vitit 2018.

Të ndarë në dy grupe sipas mjekimit:

1. Në grupin e parë 38 të mjekuar me terapi antianemike përkatësisht sir.proteinsuccinylate

2. Në grupin e dytë 38 të mjekuar me ferossucrosomial, Të mjekuar për një muaj.

Tek të gjithë të sëmurët është marrë anamneza rreth mënyrës së të ushqyerit, anemia është konstatuar sipas kritereve për diagnozë të anemisë, te të gjithë fëmijël është marrë gjaku venoz në momentin e diagnostifikimit dhe pas trajtimit njëmuajor me terapi antianemike respektivisht : në rastet kur hemoglobina ka qenë <11 g/dl dhe hematokriti <33% ,MVC 70 fL <,Fe ++ 7 ummol/l<.Moshë mesatare ka qenë 7,4 muajsh, ndarja sipas gjinisë ka qenë si vijon:47 infante të gjinisë femërore, 29 të gjinisë mashkullore.

## REZULTATET

Janë analizuar rezultatet e mara në fillim dhe pas trajtimit



me terapi antianemike në të dy grupet, respektivisht grupi i cili është trajtuar me hekur sucrosomial ka treguar përmirësim të dukshëm të parametrave si janë hgb,hct,MCV dhe Fe ++ pas përdorimit të terapisë brenda 1 muaji, ndërkaq grupi i pacientëve të trajtuar me protein succinylat ka pasur përmirësim dukshëm më të dobët sesa grupi i trajtuar me ferosucrosomial.tabela 1.

Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të hemoglobinës nga 7,1 mmol/l në 11 mmol/l në periudhën kohore njëmuajore, në raport me grupin e trajtuar me feroprotein succinilate. grafikon 1.

Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të hematokritit nga 0,30 % në 0,33 %, në periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylate.grafikon 2.

Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të MCV nga 60 fL në 75 fL periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylat grafikon3.

Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të Fee ++ nga 2,5 umol/l në 6,5 umol/l në periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylate.grafikon 4


Janë raportuar për disa nga efektet anësore të terapisë si vjellje në tre raste te pacientët e trajtuar me proteinsucinylat, ndërkaq te pacientët e trajtuar me ferosucrosomial nuk janë referuar efekte anësore.tabela 2.

Në të dy grupet e studimit vërehet qartë dallimi sa i përket efekteve anësore respektivisht në grupin e trajtuar me protein succinilate kemi në tre raste me efekte anësore të terapisë edhe atë me vjellje, në raporte me grupin e trajtuar me ferro succrosomiale.grafikon 5.


	Te trajtuar me Proteinsucinilat		Tetrajuar me Fero Sucrosomial	
	Përpara terapisë	Pas terapisë	Përpara terapisë	Pas terapisë
HGB mmol/l	7,1	10	7,1	11
Hct %	0,30 %	0,31 %	0,30 %	0,33 %
MCV fL	59	71	60	75
Fe ++ umol/l	2,5	3,5	2,5	6,5

Tabela 1:vlerat mesatare të përgjithshme nga rezultatet laboratorike pas trajtimit njëmuajor me terapi antianemike.


Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të hemoglobines nga 7,1 mmol/l në 11 mmol/l në periudhën kohore njëmuajore, në raport me grupin e trajtuar me feroproteinsuccinilate. grafikon 1.




Graf.1.Vlerat mesatare të hemoglobines në të dy grupet. Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të hematokritit nga 0,30 % në 0,33 %, në periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylate.grafikon 2



Graf. 2.Vlerat mesatare të hematokritit në të dy grupet. Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të MCV nga 60 fL në 75 fL periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylat grafikon3.



Graf. 3.Vlerat mesatare të MCV në të dy grupet. Nga llogaritja e vlerave mesatare në të dy grupet studimore rezulton që në grupin e trajtuar me ferosucrosomial kemi rritje më të lartë të vlerave të Fee ++ nga 2,5 umol/l në 6,5 umol/l në periudhën kohore njëmuajore në raport me grupin e trajtuar me proteinsuccinylate.grafikon 4




Graf. 4.Vlerat mesatare të F++ në të dy grupet.

Janë raportuar për disa nga efektet anësore të terapisë si vjellje në tre raste në pacientët të trajtuar me proteinsuccinylat, ndërkohë që pacientët e trajtuar me ferosuccrosomial nuk janë referuar efekte anësore. tabela 2

	Të trajtuar me Proteinsuccinylat	Të trajtuar me Ferro succrosomial
	Pas terapisë	Pas terapisë
Efekte anësore	3	/

Tabela 2.paraqitje tabelare e efekteve anësore në të dy grupet.

Në të dy grupet e studimit vërehet qartë dallimi sa i përket efekteve anësore respektivisht në grupin e trajtuar me proteín succinylate kemi në tre raste efekte anësore të terapisë edhe atë me vjellje, në raporte me grupin e trajtuar me ferro succrosomiale.grafikon 5.



Graf. 5.Paraqitje grafike e efekteve anësore në të dy grupet.

## PËRFUNDIMI

Trajtimi i anemive ngelet një problem i praktikës ditore me fëmijë. Normalisht, trajtimi i anemi ferodeficitare zgjat 3 muaj. Nga rezultatet e marra mund të konkludojme se:

1. Trajtimi me fero succrosomial është treguar më efektiv te përqindja më e madhe e pacientëve me anemi ferodeficitare në periudhë njëmuajore.
2. Parametrat hematologjike siç janë: hemoglobina, hematokriti, MCV (mean cel volumen), Fe ++ kanë rritje më të lartë në grupin e trajtuar me ferro succrosomiale.

3. Raporti kohore për periudhën njëmuajore në grupin e trajtuar me succrosomiale ka treguar përmirësim më të lartë në raport me grupin e trajtuar me proteín succinylat.
4. Në grupin e trajtuar me ferro succrosomiale nuk është raportuar asnjë efekt anësor, në raport me grupin e trajtuar me proteín succinylate ku janë referuar 3 raste me vjellje.

## DISKUTIMI

Mënyra e të ushqyerit tek infantët është shumë e rëndësishme dhe ndikon në rezultatet e trajtimit të anemisë ferodeficitare.

Rekomandohen produktet ushqimore të pasura me hekur sepse vetem terapia e pa shoqëruar me ushqyerje adekuate nuk është e mjaftueshme për të mbajtur në nivele të duhura parametrat hematologjike, gjithashtu nuk garanton rritje dhe zhvillim normal veçanërisht në fazën infantile kur edhe zhvillimi është shumë intensiv.

Terapia me ferro succrosomial efektet e veta pozitive i ka edhe në aspekt të resorbimit të mirë në zorrë si pasojë e përbërjes së saj, pra nuk nevojitet edhe dhënie e acidit ascorbic (vitamin C) e cila ka efekt resorbues me të lartë të hekurit në zorrë.

Gjithmonë duhet rekomanduar terapinë antianemike e cila shkurton periudhën e trajtimit dhe nuk ka efekte anësore. Parandalimi i anemisë sideropenike me preparate të hekurit në menyre perorale bëhet te:

- - Fëmijët me përqëndrim të ulët të hgb-së
- - Fëmijët të cilët ushqehen me qumësht të lopës prej lindjes
- - Fëmijët e lindur para kohe
- - Fëmijët me hipoksemi kronike
- - Fëmijët me infeksione të shpeshta
- - Fëmijët me standard të ulët ekonomik.

Autorët si Gómez-Ramirez S, Brillì E, Tarantino G, Muñoz M, më temën Succrosomial® Iron si hekur i gjeneratës së re për përmirësimin dhe plotësimin Oral, rekomandojnë që succrosomial si preparat peroral del si një mundësi më e vlefshme për trajtimin e ID-së, edhe më shumë për subjektet me intolerancë ndaj ose jo efikasitetin e kripërave të hekurit.

Lopez A, Cacoub P, Macdougall IC, Peyrin-Biroulet L. në studimet e tyre hedhin tezën e trajtimeve të reja të anemise te femijet dhe njerëzit e moshave të rritura

lidhur me Hepcidin i cili ka një rol kyç në homeostasen e hekurit dhe mund të jetë një objektivi i ardhshëm diagnostik dhe terapeutik.

Gwetu TP, Chhagan MK, Taylor M, Kauchali S, Craib M. më punimet e tyre rreth kontrollit të anemisë dhe interpretimi i testeve biokimike për statusin e hekurit te fëmijët, rekomandojnë shqyrtimin e rregullt të anemisë te fëmijët e moshës shkollore nga komunitetet e pafavorizuara, me qëllim për të parandaluar pasojat të cilët i shkakton anemia në rritjen e tyre.

Mafodda A, Giuffrida D, Prestifilippo A, Azzarello D, Giannicola R, Mare M, Maisano R. në punimin e tyre "Oral sucrosomial iron versus intravenous iron in anemic cancer patients without iron deficiency receiving darbepoetin alfa": rekomandojnë që hekuri oral i sucrosomit siguron një rritje të ngjashme të niveleve të Hb-së, dhe me tolerancë më të lartë në raport me hekurin intravenoz.

Elli L, Ferretti F, Branchi F, Tomba C, Lombardo V, Scricciolo A, Doneda L, Roncoroni në punimin e tyre "Sucrosomial Iron Supplementation in Anemic Patients with Celiac Disease Not Tolerating Oral Ferrous Sulfate" rekomandojnë që Sucrosomial mund të jetë efektiv në sigurimin e plotësimin të hekurit në popullatat e vështira për t'u trajtuar, siç janë pacientët me CD, IDA dhe intolerancën ndaj sulfatit të hekurit.

Fabiano A, Brilli E, Fogli S, Beconcini D, Carpi S, Tarantino G, Sfera Y. në punimin "Sucrosomial® iron absorption studied by in vitro and ex-vivo models", konkludojnë se Sideral® RM ruan hekurin në SGF dhe është më i përshtatshmi për internalizimin e Fe<sup>3+</sup> nga qelizat Caco-2, mbrojnë Fe<sup>3+</sup> nga reduktimi enzimatik dhe nxitja e absorbimit Fe<sup>3+</sup> në epitelin e zorrëve.

#### LITERATURA:

1. M. Azemi. Muje Shala, Anemija sideropenike, *Pediatrics*, Prishtinë, 2010:791-795.
2. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2528681>.
3. Janic D. Anemija. Ne: Stepanovic R. *Pediatrics* Beograd. "Branko Donovic", 2001 387-396.
4. T. Stojcevski Anemija, Stojcevski T., Zelezna deficitna anemija. Ne: *Hematologija* T. Stojcevski i sorabotnici Shkup. "MEDIS -informatika" 1995: 67-90.
5. Gjuric G. Prehrana Ne: Mardesic G. *Pediatrics* Zagreb. "Shkolska knjiga" d.d., 2000:233-269
6. M. Boranic Anemije Ne: Mardesic G. *Pediatrics* Zagreb. "Shkolska knjiga, d.d. 2000:642-649.
7. American Academy of Pediatrics. Work Group on breastfeeding. Breastfeeding and the use of human milk. *Pediatrics*, 1997: 100:1035
8. Memedali Azemi. Muje Shala, Anemija, *Pediatrics*. Prishtinë, 2010: 788-789.
9. Memedali Azemi. Muje Shala, Anemija, *Pediatrics*. Prishtinë, 2010: 793-794.
10. S. Braho. A. Mucko, Subtancat antianemike. *Farmakologjia*, Tiranë 1994 Shtëpia botuese Hipokrati :317-319
11. Stojceski T, Zhelezno deficitna anemia. *Hematologija*. Skopje 1995:81-88

#### TREATMENT CORRELATION OF

## SIDEROPENIC ANEMIA WITH IRON (III) PROETIN SUCCINYLATE (IPS) AND FERRO SUCROSOMIAL (FS)

Sani Bajrami<sup>1</sup>, Anita Sinani<sup>1</sup>, Florin Besimi<sup>1</sup>, Sanije Berisha<sup>1</sup>

<sup>1</sup>PHO.PEDIATRIKA, Tetovo

<sup>1</sup>Clinical Hospital Tetovo

<sup>1</sup>Faculty of Medical Sciences, Tetovo

<sup>1</sup>Department of Obstetry –Gyneacology, Clinical Hospital Tetovo

<sup>1</sup>Department of Clinical Byocemistry, Clinical Hospital Tetovo

---

### ABSTRACT

**INTRODUCTION:**By anemia we mean the reduced number of erythrocytes or the reduced amount of Hgb or one and the other at the same time, below the reference age values. Iron is a metal that takes intoxication and is necessary for the synthesis of hemoglobin and the saturation of its storage tanks. During the different periods of life, daily needs for iron as well as babies are increased, and if this need is not met then hypochromic anemia is developed.

**AIM:** This paper aims to determine the time report and the results of the treatment of iron-and-blood fermentative anemia (III ) -proteinsuccinyls and ferrosucrosomial

**MATERIALS AND METHODS:** The prospective study was performed during the anemia screening at infants, at IPSH PEDIATRIKA Tetovo, and the Clinical Laboratory at the Tetovo Clinical Hospital, 76 infants were diagnosed with ferhatic anemia, age 1- 12 months, treated in the period January 2018 - June 2018. The average age was 7.4 months, the gender was as : 47 female, 29 male.

**RESULTS:** The results obtained at the beginning and after treatment with antianemic therapy in both groups, respectively the group which has been treated with iron sucrosomial has shown significant improvement in parameters such as hgb, hct, MCV and Fe ++ after using the therapy internally 1 month, while the group of patients treated with succinylated protein has had significantly worse improvement than the ferrosucrosome-treated group.

**CONCLUSION:** Fero sucrosomial treatment has been shown to be most effective in the largest percentage of patients with ferodeficitonic anemia, respectively parameters such as hgbhct MCV and Fe ++ have higher increases in the iron-treated sucrosomial group for a period of one month.

**DISCUSSION:** The way of feeding infants is very important and affects the results of the treatment of ferhatopharyngeal anemia, iron-rich food products are recommended and the use of therapy that shortens the treatment period and no side effects.

Key words: ferodeficitare anaemi,tretman

---

# TRAJTIMI I ANEMIS RENALE ME ERITROPOETIN-EFEKTET E INFEKSIONIT TË KATETERËVE FEMORAL MBI EFIKASITETIN E TRAJTIMIT

Sela N., Zabzun M., Poposki A., Dalipi A., Avramoski M., Zhaku S.

Instituti i Nefrologjisë - Strugë, R.e Maqedonisë

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 257-261

## ABSTRAKT

Rezyme: Te pacientët me insuficiencë renale kronike, të shpeshta janë infeksionet nga kateterët per hemodializë. Trajtimi i anemisë renale te këto pacientë, është me eritropoetin. Frekuenca e dhënies së eritropoetinit është e ndryshme, më shpesh jepet eritropoetin me veprim të shkurtër. Në kohën e fundit përdoret eritropoetin me veprim të zgjatur - një herë në muaj. Efekti i trajtimit ndryshon te pacienët me kateter nga ato me fistulë A-V. Te këto pacientë është e nevojshme rritja e dozës së eitropoetinit për rreth 25% në krahasim me dozën fillestare.

Fjalë kyçe: Kateter infeksion, eritropoetin, insuficiencë renale.

## HYRJE

Anemia renale është komplikim i rëndë i insuficiencës renale kronike. Anemia tek pacientët që trajtohen në menyrë kronike me hemodijalizë çon në co-morbiditet, sëmundje kardiovaskulare, ndryshim të kualitetit të jetës si dhe zvogëlim të jetëgjatësisë te pacientët të cilët trajtohen me hemodijalizë.

Aplikimi i eritropoetinës në mjekimin e anemisë renale te këto pacient, në menyrë të dukëshme ka përmirësuar shkallën e jetëgjatësisë si dhe kualitetin e jetës. Përveç preparateve klasike të eritropoetinës, si që janë : Eritropoetin alfa , beta , omega , si dhe biosimilari, në kohën e fundit janë përdorur edhe agensa me gjysëmjete të zgjatur të eliminimit dhe si rrjedhojë e kesaj edhe efekt të vazhduar të mjekimit, si që janë Darbepoetin dhe Mircera.

Mircera është aktivizues i vazhduar i receptorëve të eritropoetinës me aplikim një herë në muaj me gjysëm jete të zgjatur 134 orë dhe si pasojë e kësaj në mënyrë shumë efikase stabilizohen vlerat e hemoglobinës në periudhën prej një muaji.

Te pacientët me insuficiencë renale në trajtim të rregullt me hemodijalizë tek të cilët është vendosur kateter qendror venoz -femoral, jugular ose subklavia, janë të shpeshta infeksionet të cilët e zvogëlojnë efektin e

eritropoetinës në mënyrë të theksuar. Në këtë rast rritet doza e dhënies së eritropoetinës.

## QËLLIMI

Optimalizimi (përmirësimi) i trajtimit të anemisë renale me aplikimin e eritropoetinës me veprim të zgjatur; metoxypolyethylen glycol-epoetin beta, aktivizues i vazhduar i receptorëve të eritropoetinës - Mircera.

Efikasitet dhe siguri në trajtimin me Mircera.

Korigjimi i dozës së eritropoetinit në rastet me infeksion të kateterit.

## PACIENTËT DHE METODAT

Janë ndjekur pacientë me insuficiencë renale në program të rregullt me hemodijalizë në Institutin e nefrologjisë - Strugë në periudhë kohore prej 8 muajsh.

Në studim janë përfshirë pacientë me status adekuat të hekurit ; serum feritin >100ng/ml dhe saturimi me transferin >20% sipas rekomandimit të udhëheqësve botëror për trajtimin e anemisë renale (KDOQI-2006 GUIDELINES).

Janë ndjekur pacientë me infeksion të kateterit - me markerë të rritur të inflamacionit, me infeksion të

shprehur klinikisht. Pacientët ishin të randomizuar (1:1:1) në tre grupe : Grupi A ( grupi Mircera), grupi B (standard eritropetin), grupi C (pacient[ me kateter femoral - CRP> 30 mg/L. Numri i pacientëve : 33.

Pacientët në grupin A pranuan Mircera prej 50 dhe 100 mikrogram një herë në 2 javë - subkutan (Q2W) në fazën e korigjimit si dhe një herë në 4 javë në dozë prej 50, 100 ose 150 mikrogram ( Q4W) në fazën e mbajtjes.

Pacientët në grupin B pranuan eritropetin me veprim të shkurtër nga 2000 IU 3 herë në javë gjatë gjithë kohës së observimit prej 8 muajsh.

Te pacientët e grupit C me CRP > 30 mg/L janë dhënë të dy llojet e eritropetinës.

Gjatë kohës së dozës mbajtëse, dozat janë përshtatur për mbajtjen e vlerave të hemoglobinës prej 11-13 g/dl.


REZULTATET

MIRCERA GRUPI - A
MOSHA : 59,10 VJET. SD=+/- 9,05
GJINIA: M: 54.55%, F: 45.45
PERIUDHA NE HD: 4-6 VJET. SD: +/- 6.08


EPO GRUPI -B
MOSHA: 62.64 VJET. SD: +/- 14.13
GJINIA: M: 56.55, F:43.45.
PERIUDHA NE HD: 5-7 VJET.SD: +/- 4.4.

GRUPI C - INFEKSIONET E KATETERIT
MOSHA: 66.58 VJET SD:+/- 13.12
GJINIA: M: 54.45, F:45.55.
PERIUDHA NE HEMODIJALIZE :5-6 VJET

DIJAGNOZA RENALE %




EFEKTET ANESORE TE TRAJTIMIT = 0 %




MIRCERA GROUP - A : Hb levels gr./L

Patients	Hb baseline	Hb - 2 weeks	Hb - 1 month	Hb - 4 months	Hb - 8 months
A	107	132	112	114	117
B	104	110	84	85	107
C	104	110	99	105	113
D	96	90	121	130	141
E	100	115	122	121	119
F	114	113	103	109	116
G	96	82	94	99	111
H	97	113	104	108	116
I	106	103	114	110	106
J	103	107	110	118	132
K	110	115	115	117	120
Average	103.36	108.18	107.09	110.55	118



EPO GRUPI - B : VLERAT E Hb /gr/L

Patients	Hb start	Hb - 2 weeks	Hb - 1 month	Hb - 4 months	Hb - 8 months
A	93	105	101	105	110
B	123	125	150	142	140
C	125	102	110	109	105
D	120	114	128	123	119
E	104	128	116	121	129
F	100	97	89	101	123
G	112	114	115	127	140
H	110	103	100	108	120
I	106	103	101	105	111
J	121	129	132	126	120
K	105	115	115	118	120
Average	110.82	112.27	114.27	116.82	121.55



KATETER GRUPI - C : VLERAT E Hb /g/L

Patients	Hb start	Hb - 2 weeks	Hb - 1 month	Hb - 4 months	Hb - 8 months
A	88	92	96	96	100
B	100	102	104	106	110
C	96	96	96	100	110
D	89	92	94	100	106
E	95	98	100	102	108
F	86	88	86	84	80
G	88	92	92	88	82
H	96	96	96	100	106
I	89	92	98	104	110
J	92	94	100	106	110
K	92	96	98	100	108
Average	90.82	92.62	94.82	96.84	105.84

## DISKUTIMI

Në studim janë përfshirë pacientë me insuficiencë kronike renale në program të rregullt me hemodijalizë dhe trajtimi i anemisë renale me eritropoetin me frekuenca të ndryshme të aplikimit të eritropoetit : 3 herë në javë ose një herë në muaj si dhe efekti i korigjimit të anemisë renale gjatë infeksionit të kateterëve qendror venoz.

Në grupin e parë - A/ vlerat target të Hgb u arriten në 78% nga grupi i ndjekur, në grupin e dytë - B/ vlerat target u arritën në 72% nga grupi i ndjekur, ndërsa në grupin e tretë - C/ në 64 %.

Në fazën mbajtjes së Hgb vlerat target u arriten në 82 % në grupin A, respektivisht 74 % në grupin B. Në grupin e tretë - C vlerat target të Hgb u arritën në 64% dhe atë me rritje të dozës së eritropoetit për 25 % në pajtueshmëri me DOQI GUIDELINES.

Te dy pacientët të grupit C ( F dhe G) për shkak të

infeksionit të rëndë të kateterit femoral për hemodializë dhe rezistencës në trajtim u bë dhënja e një njësie mase eritrocitare.

Mekanizmi bazë patofiziologjik për përgjigjen e dobët në trajtimin e anemisë gjatë infeksionit të kateterëve është aktivizimi i citokineve inflamatorë (TNF ALFA ) interferon gama dhe interleukin 1 të cilët në mënyrë direkte pengojnë diferencimin dhe proliferimin e qelizave progenitore eritroide.

Gjithashtu këto citokine pengojnë prodhimin e eritropoetinës në veshka si dhe inhibojnë absorbimin duodenal të hekurit dhe lirimimin e hekurit nga makrofagët dhe hepatocitët.

## PËRFUNDIMI

Të dy grupet e eritropoetinës me korigjime të vogla të dozave në fazën e dozës mbajtëse mund ti mbajnë vlerat



optimale (target vlerat) të Hgb.

Në rastet me infeksion të kateterit, të cilat janë mjaft të shpeshta tek pacientët me hemodijalizë (HD), ekziston problem serioz në mbajtjen e vlerave optimale të Hgb. Te këto pacientë bëhen korigjime të shpeshta të dozave me zmadhimin e dozës rreth 25% nga doza paraprake në periudhën prej dy kontrolleve të Hgb.

Në rast të një rezistence të plotë bëhet substitiuimi me masë eritrocitare dhe me dhënien graduale të eritropoetinës.

## CONCLUSION

To realizing the efficiency of anemia management very important step is to reduce the administration frequency of ESAs.

Time savings due to reduction of extended dose intervals have an important benefit in clinical practice for patients with CKD as well as for health care professionals.

MIRCERA is very superior ESA with unique receptor activity and long half-life, which subcutaneous administration at extended intervals ( once monthly) effectively maintained stable Hb levels in patients with CKD.

Higher rHuEPO doses may be required to maintain similar or slightly lower mean hemoglobin values among chronic hemodialysis patients with higher numbers of catheter insertions and VA infections, compared to patients without any.

# INFEKSIONET INTRAHOSPITALE VS ONE DAY SURGERY

Ilber Besimi<sup>1,2</sup>, Bekim Ismaili<sup>2</sup>, Rrezearta Elezi<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Spitali Klinik, Departamenti i Kirurgjisë dhe Traumatologjisë, Tetovë, Maqedoni

<sup>2</sup>UT, Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë, Tetovë, Maqedoni

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 262-264

## ABSTRAKT

Hyrja: Përparsitë e one-day surgery në prevenimin e infeksioneve nozokomiale janë një nxitje e punëtorëve shëndetësor në kirurgji për prevenimin e tyre. Infeksionet intrahospitale definohe si sëmundje që zhvillohet 48 orë pas hospitalizimit. Zhvillohen te 5-10 % e të hospitalizuarve. Trajtimi adekuat dhe bashkohor bën të mundur zvoglimin infeksioneve intrahospitale. Qëllimi i punimit: Qëllimi i këtij punimi qëndron në rëndësinë e one-day surgery në prevenimin e infeksioneve intrahospitale, zvoglimin e përdorimit të antibiotikëve dhe ofrimin e mjekimit bashkëkohor. Matriali dhe metoda: Në studim janë përfshirë 133 të sëmurë të operuar. Pacientët i kemi ndarë në dy grupe: grupi I-rë janë 66 të trajtuar me one day surgery dhe grupi II-të 67 pacientë me qëndrim mesatar spitalor 4.3 ditë. Pacientët janë trajtuar brenda vitit 2018. Rezultatet: Në grupine I-rë me one-day surgery 77.3% ishin meshkuj dhe 22.7% femra, ndërsa në grupin e II-të 73.1% ishin meshkuj dhe 26.9% femra. Infeksionet nozokomiale në grupin e I-rë u regjistruan tek 10.61%, ndërsa në grupin e II-të tek 44.75%. Shkaktarë më i shpesht i infeksioneve intrahospitale ishte Staphylococcus aureus në 79% të rasteve. Përfundim: Aprovimi i trendeve bashkëkohore dhe qëndrimi më i shkurtër në spital e parandalon paraqitjen e infeksioneve nozokomiale dhe e zvoglon përdorimin e antibiotikëve.

Fjalë kyç: Infeksionet intrahospitale-nozokomiale, one-day surgery

## Hyrja

Përparsitë e one day surgery në prevenimin e infeksioneve intrahospitale paraqet një nxitje të punëtorëve shëndetsor që merren me punë kirurgjike. Infeksionet intrahospitale definohe si sëmundje që zhvillohet 48 orë pas hospitalizimit. Vlerohet se infeksionet intrahospitale zhvillohen tek 5-10 % e pacientëve të hospitalizuar (1, 3, 9).

Frekuenca dhe llojet infeksioneve intrahospitale varen nga shumë faktor, si profili i spitalit, gjendja imunologjike e pacientit, higjiena spitalore, përvoja dhe aftësitë e personelit mjekësor, doktrina e përdorimit të antibiotikëve me qëllime preventive apo curative, etj. Shfaqja e infeksioneve intrahospitale e komplikom edhe më shumë trajtimin e sëmundjes fillestare të pacientit dhe në të njëjtën kohë e rrit koston e kurimit dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në spital. Të dhënat e fundit për SHBA dhe EU tregojnë se rreth 2 milion pacientë në vitë vijnë nga infeksione intrahospitale gjë që e zgjat qëndrimin e tyre mesatarisht për 5.3 ditë në spital dhe e rrit koston e kurimit për rreth 4.5 miliard dollarë. Prevalence e infeksioneve intrahospitale në këtë studim

është 8.2 % (2, 10).

Shkaktarët më të shpesht të infeksioneve intrahospitale janë: Escherichia coli, kuagulazë-negativë stafillokokët, Staphylococcus aureus (veçanërisht meticilin rezistent stafolokoke), Enterococcus, Psuedomonas auriginosa, Acinetobacter species pneumoniae, Klebsiella, Enterobacter, Proteus mirabilis, Serratia, si dhe bakteriet anaerobe gram-pozitive (Propionibacterium, Bacteroides). Në vitet e fundit si shkaktarë i infeksioneve intrahospitale paraqiten edhe Legionella, Clostridium difficile dhe Micoplasma hominis. Gjithashtu, me theks të veçantë si risk për puntorët shëndetësor paraqiten edhe viruset, si virusi i Hepatitit B dhe C, HIV virusit, Kohëve të fundit rriten në masë edhe infeksionet intrahospitale të shkaktuara nga myket e ndryshme si Candida albicans, Cryptococcus neoformans, Aspergillus, Candida Krusei, C. parapsilosis, B. lusitaniae dhe të tjera lloje jo-albikans. Viruset në numrin e përgjithshëm të infeksioneve intrahospitale marrin pjesë me 25-30 % (8, 9, 11).

Rëndësia e one day surgery qëndron në faktin se me shkurtimin e qëndrimit në spital prevenohen infeksionet

intra-hospitale, zvoglohet kostoja e kurimit koha e paaftësisë për punë (6, 7, 8).

### Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi qëndron në rëndësinë e one day surgery në prevenimin e infeksioneve intra-hospitale, zvoglimin e përdorimit të antibiotikëve dhe në ofrimin e trajtimit bashkëkohor.

### Materiali dhe Metoda

Në studim janë përfshirë 133 të sëmurë të operuar. Pacientët i kemi ndarë në dy grupe: grupi I-rë gjithsej 66 të trajtuar me one day surgery dhe grupi II-të gjithsej 67 pacientë me qëndrim mesatar spitalor prej 4.3 ditëve. Pacientët janë trajtuar brenda vitit 2018. Diagnoza e komplikimeve është vënë në bazë të ekzaminimit klinik 48 orë pas operimit, brisit dhe materialit të marur nga plaga për analizë mikrobiologjike (serom).


### Rezultatet

Gjatë këtij studimi u analizuan komplikimet në kuptim të skuqjes së plagës, rjedhja e seromit nga plaga dhe shërimi per secundum i plagës.

Tabela 1. Frekuenca e komplikimeve

	one day surgery		4.3 dite	
	M	F	M	F
per primam	46	13	26	11
skuqje të plagës	3	1	10	4
serom	2		12	2
per secundum		1	1	1
Gjithsej	51	15	49	18
	66		67	

Grafikoni 1.



Frekuenca e pacientëve sipas gjinisë

Tabela 2. Frekuenca e komplikimeve sipas grupeve

	one day surgery	4.3 dite
Pa Komplikime	89.39	55.25
Me Komplikime	10.61	44.75
Gjithsejt	100	100

Tabela 3. Frekuenca e shkaktarëve të infeksioneve intra-hospitale

	Përqindja
Staphylococcus aureus	78.95
Psuedomonas auriginosa	9.77
Enterococcus	8.27
Candida albicans	1.50
Klebsiella	1.50
Gjithsejt	100.00

### Diskutimi

Trajtimi bashkëkohor si one day surgery jep një komoditet të mirë në trajtimin e mirëfillt të pacientëve dhe në të njëjtën kohë zvoglon mundësinë e komplikimeve, kohëzgjatjen e kurimit, zvoglon përdorimin e antibiotikëve dhe në periudhën afatgjatë zvoglon mundësinë e zhvillimit të rezistencës së mikrobeve ndaj antibiotikëve (6, 10, 11).

Në studimin tonë pacientëve të grupit të I-rë ju dha vetëm një dozë e antibiotikut e grupit të cefalosporineve të gjeneratës së tretë me rrugë intavenoze, ndërsa grupi i II-të me qëndrim në spital pranoi dy herë në ditë cefalosporin të gjeneratës së dytë, 5 ditë me rrugë intavenoze (2, 5, 9, 11).

Gjate trajtimit kirurgjikal dukshëm zvoglohet mundësia e shfaqjes së komplikimeve dhe e përdotimit të antibiotikëve gjë të cilën e rekomandon edhe OBSH (6).

### PËRFUNDIM

Infeksionet intra-hospitale paraqesin problem shëndetësor që kërkon qasje serioze dhe profesionale.

Aprovimi i metodave bashkëkohore terapeutike si one day surgery e zvoglon mundësinë e paraqitjes së infeksioneve intra-hospitale.

Zvoglimi i infeksioneve intra-hospitale e zvoglon koston e kurimit dhe qëndrimin në spital.

Prevenimi i infeksioneve intra-hospitale zvoglon përdorimin e antibiotikëve dhe mundësinë e zhvillimit të rezistencës të bakterieve

One day surgery si protokol bashkëkohor na jep mundësinë e ofrimit të shërbimeve kualitative shëndetsore me benefit të shumëfishtë.

### Bibliografia

1. R. J. Aldwinckle and J. E. Montgomery (2004) Unplanned admission rates and postdischarge complications in patients over the age of 70 following day case surgery Anaesthesia Volume 59 Issue 1 Page 57.
2. J Henderson, MJ Goldacre, M Griffith and HM Simmons (1989) Day case surgery: geographical variation, trends and readmission rates Journal of Epidemiology and Community Health Volume 43 301-30.
3. Ogg TW, Hitchcock M, Penn S. (1998) Day Surgery Admission and Complications Ambulatory Surgery 6: 101 - 106.
4. Audit Commission (2001) Day surgery. Acute Hospital Portfolio Review of National Findings No.4.
5. Audit Commission (1990) A Short Cut to Better Services. Day Surgery in England and Wales HMSO.
6. Audit Commission (1992) All in a day's work: an audit of day surgery in England and Wales.
7. Department of Health (2002) Day Surgery: Operational guide: Waiting, booking and choice.
8. NHS Modernisation Agency (2004) Ten High Impact Changes.
9. Thornes R. (1991) Just for the day: children admitted to hospital for day treatment. NAWCH on behalf of Caring for Children in the Health Services.
10. Audit Commission (2003) Operating Theatres, Acute Hospital Portfolio Review of National Findings.

## INTRAHOSPITAL INFECTIONS VS ONE-DAY SURGERY

Ilber Besimi<sup>1,2</sup>, Bekim Ismaili<sup>2</sup>, Rrezearta Elezi<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Clinical Hospital, Department of Surgery and Traumatology, Tetova, Macedonia

<sup>2</sup>UT, Faculty of Medical Science, Tetova, Macedonia

### SUMMARY

Introduction: The advantages of one-day surgery in the prevention of nosocomial infections are an incentive for health workers in preventing their surgery. intrahospitale infections defined as disease that developed 48 hours after hospitalization. Developed in 5-10% of hospitalized persons. Adequate and modern treatment allows reduction intrahospital infections. The aim of the paper: The purpose of this paper lies in the importance of one-day surgery in the prevention of intrahospital infections, reduce use of antibiotics and provision of modern treatment. Material and methods: The study included 133 patients operated. We divided patients into two groups: group I-66 I have dealt with one day of surgery and group II 67 patients with an average hospital stay 4.3 days. Patients were treated in 2018. Results: In group I of the one-day surgery 77.3% were male and 22.7% females, while in group II were 73.1% male and 26.9% females. nosocomial infections in the I-st group was recorded at 10.61%, while in Group II to 44.75%. The most frequent cause of infections was Staphylococcus aureus intrahospitale in 79% of cases. Conclusion: The adoption of modern trends and shorter stay in hospital prevents nosocomial infections and reduces use of antibiotics.

Key words: intrahospital - nosocomial infections, one-day surgery

Adresa e autorit/Author adresse:

Ilber Besimi, kirurg, Traumatolog

Rr. Gjorçe Petrov Nr 44, 1220 Tetovë, Maqedoni

Tel: 075 200 010

e-mail: ilber-besimi@t-home.mk

# MENAXHIMI I SHTATZANIVE ME BLIGHTED OVUM DHE MISSED ABORTION NË SPITALIN E PËRGJITHSHËM NË FERIZAJ

Efendi Sahiti

Spitali i Përgjithshëm-Ferizaj

Efamed@hotmail.com

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 265-270

## ABSTRAKTI

Hyrja: Shtatzania është një ngjarje fiziologjike, por që mund të shoqërohet me procese patologjike. Në 5-20% të rasteve komplikohet me procese patologjike, në mesin e të cilave bënë pjesë Blighted ovum dhe Missed abortion.

Qëllimi i punimit: Është të bëjë identifikimin me kohë të këtyre shtatzanive patologjike, trajtimin adekuat të tyre, të krahasoj efikasitetin e ndërprerjes së këtyre shtatzanive me metoda terapeutike, respektivisht kirurgjike.

Materiali dhe metodat: Hulumtimi është i tipit transversal, duke shfrytëzuar pyetësor. Metoda e anketimit ka qenë përmes intervistës sy me sy gjatë periudhës 28.02.2017 deri me 25.5.2018. Intervista është bërë në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj, duke përdorë metodën e përcaktimit të mostrës së rastit.

Rezultatet: Punimi përmban shtatzënat e identifikuar me Blighted ovum dhe Missed abortion gjatë periudhës së lartcekur në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt dhe mënyrat e trajtimit. Gjatë kësaj periudhe në këtë Spital janë identifikuar gjithësej 60 shtatzëna me këtë patologji, prej tyre 16 ishin me Blighted ovum si dhe 44 me Missed abotion. Me Blighted ovum më shumë ishin ato që kishin shtatzaninë e parë, gjegjësisht 31.25%, kurse ato që kishin Missed abortion ishin në shtatzaninë e tretë, gjegjësisht 31.81%. Shumica prej tyre kishin marrë Acid folik, gjatë kësaj periudhe. Nga ky numër i të anketuarave (60), vetëm njëra gjatë shtatzënisë kishte bërë strisho vaginale dhe cervikale ndërsa 37.5% e shtatzënave me Blighted ovum ishin të atakuara nga virozat e ndryshme, kurse te ato me Missed abortion kjo shifër arrinte në 45.4%. Duanpirëse ishin 37.5% të shtatzënave me Blighted ovum, gjegjësisht 25% të atyre me Missed abortion. Me Misoprostol tab. ishin trajtuar dhe përfunduar 68.75% e shtatzanive me Blighted ovum, kurse te ato me Missed abortion arrinte shifrën 81.81%.

Përfundimi: Menaxhimi medikamentoz me Misoprostol tab. për ndërprerjen e këtyre shtatzanive është treguar shumë efikas dhe pa efekte anësore.

Fjalët kyçe: Shtatzëna, Blighted, Missed.

## HYRJE

Shtatzania është një ngjarje fiziologjike që imponon ndryshime funksionale dhe anatomike. Kur këto ndryshime janë në një shkallë të moderuar janë normale, por nganjëherë mund të bëhen patologjike dhe të rrezikojnë shëndetin e nënës. Shtatzania edhe pse është një ngjarje fiziologjike ajo mund të komplikohet në 5-20% të rasteve me procese patologjike që janë të rrezikshme për shtatzënë dhe frytin(1). Në mesin e këtyre shtatzanive patologjike bëjnë pjesë edhe shtatzaninë me Blighted ovum dhe Missed abortion.

Shtatzaninë me Blighted ovum janë shtatzani

anembrionale, që ndodhin kur vdes embrioblasti por trofoblasti zhvillohet edhe ca kohe. Nga pikëpamja klinike rritja e mitrës është më e ngadalshme se sa te shtatzaninë normale, po ashtu vlerat e HCG janë më të ulta. Ekzaminimi ultrasonografik karakterizohet me qese gestative të zbrazët, pa struktura embrionale. Si shkaktar i shtatzanive anembrionale më së shpeshti janë: çrregullimet kromozomale, infeksionet, intoksikacionet në muajt e parë të shtatzanisë(2). Një shtatzani konsiderohet si anembrionale kur në një ultratingull transvaginal vërehet qesja e gestacionit me diametër më të madh se 25 mm. pa embrion dhe pa sakusin vitelin(3).

Sipas përkufizimit Missedi është një vdekje në miter e embrionit ose fetusit para javës së 20 të shtatzanisë me produkte të mbajtura të konceptimit(4). Shkaqet e vdekjeve të hershme të fetusit janë të shumta dhe shpesh komplekse, por arsyet më të shpeshta janë:

- 1.Çrregullimet hormonale
- 2.Faktorët imunologjikë
- 3.Sindromi antifosfolipid
- 4.Anomalitë kromozomale
- 5.Sëmundjet infektive akute ose kronike
- 6.Faktorët e jashtëm
- 7.Varësia: droga, alkooli, pirja e duhanit(5)

Simtomat e një Missed abortioni mund të jenë një dhimbje e lehtë e barkut, dobësi e shtazënës, gjakderdhje të intenzitetit të ndryshëm nga mitra. Në disa raste këto shtazëna vazhdojnë të kenë simptoma të shtatzanisë (të përziera, lodhje) pasi ato ende mund të kenë nivele të larta të hormoneve qarkulluse. Ato shpesh nuk kanë as gjakderdhje.

Diagnoza përcaktohet në bazë të anamnezës, ekzaminimit klinik dhe laboratorik, me këtë rast konstatohet një nivel më i ulët i beta HCG(5). Në ekzaminimin ultrasonografik kemi mundësi të RZF (mundësi e rrahjes fetale). Ekzaminimi ultrasonografik është vendimtar për përcaktimin e diagnozes.

## QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit është :

- 1.Të bëjë identifikimin me kohe të këtyre shtatzanive patologjike

Tabela 2.Shtatzania me radhë të rastet me Blighted ovum dhe Missed abortion

Blighted ovum			Missed abortion		
Shtatzania me radhë	Numri i shtazënave	%	Shtazania me radhë	Numri i shtazënave	%
Shtatzania e parë	5	31.25	Shtazania e parë	11	25
Shtatzania e dytë	4	25	Shtatzania e dytë	4	9.09
Shtatzania e tretë	2	12.5	Shtazania e tretë	14	31.81
Shtatzania e katërt	2	12.5	Shtatzania e katërt	10	22.72
Shtatzania e pestë	1	6.25	Shtatzania e pestë	3	6.81
Shtatzania e gjashtë	2	12.5	Shtatzania e gjashtë	2	4.54
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>100.0</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>

- 2.Trajtimin adekuat të këtyre shtatzanive

- 3.Të krahasoj efikasitetin e ndërprerjes së këtyre shtatzanive me metoda terapeutike, respektivisht kirurgjike.

## MATERIALI DHE METODAT

Hulumtimi është i tipit transversal, duke shfrytëzuar pyetësor. Metoda e anketimit ka qenë përmes intervistës sy me sy gjatë periudhës 28.02.2017 deri me 25.5.2018. Intervista është bërë në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj, duke përdorur metodën e përcaktimit të mostrës së rastit. Intervista është bërë pas kërkimit të lejes me gojë nga shtazënata duke garantuar fshehtësinë e saj.

## REZULTATET

Punimi përmban shtazënata e identifikuara me Blighted ovum dhe Missed abortion gjatë periudhës së lartcekur në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt dhe mënyrat e trajtimit. Gjatë periudhës 28.02.2017 e deri me 25.5.2018 në këtë Spital janë identifikuar gjithsej 60 shtazëna me këtë patologji, prej tyre ishin 16 me Blighted ovum si dhe 44 me Missed abortion.

Tabela 1.Numri i shtazënave me Blighted ovum dhe Missed abortion

Blighted ovum		Missed abortion		Totali	
Numri i shtazënave	%	Numri i shtazënave	%	N	%
16	26.66	44	73.34	60	100.0


Nga ky numër i shtazënave të identifikuara, 5 prej tyre e kishin shtatzaninë e parë, 4 shtatzaninë e dytë, 2 shtatzaninë e tretë, 2 shtatzaninë e katërt, 1 shtatzaninë e pestë dhe 2 shtatzaninë e gjashtë. Këto raste ishin me Blighted ovum, kurse me Missed abortion 11 e kishin shtatzaninë e parë, 4 shtatzaninë e dytë, 14 shtatzaninë e tretë, 10 shtatzaninë e katërt, 3 shtatzaninë e pestë dhe 2 shtatzaninë e gjashtë.

Me qëllim që të kemi informata më të sakta se në cilën javë të shtatzanisë është identifikuar kjo patologji, shtatzënat në fjalë janë pyetur se kur është bërë kontrolla e pare te gjinekologu, me këtë rast kemi marrë këtë përgjigje: te rastet me Blighted ovum 5 ishin kontrolluar në javën e pare,3 në javën e pestë,3 në javën e gjashtë,4 në javën e shtatë dhe 1 në javën e tetë, kurse te rastet me Missed abortion 10 ishin kontrolluar në javën e katërt,15 në javën e pestë,11 në javën e gjashtë,5 në javën e shtatë dhe 3 në javën e tetë.


Tabela 3.Javët e shtatzanisë kur u kontrolluan këto paciente për herë të parë

Blighted ovum			Missed abortion		
Javët e shtatzanisë	Numri i shtatzënave	%	Javët e shtatzanisë	Numri i shtatzënave	%
Java e katërt	5	31.25	Java a katërt	10	22.72
Java e pestë	3	18.75	Java e pestë	15	34.09
Java e gjashtë	3	18.75	Java e gjashtë	11	25
Java a shtatë	4	25	Java e shtatë	5	11.36
Java e tetë	1	6.25	Java e tetë	3	6.81
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>100.0</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>

Tani më dihet që në zhvillimin e shtatzanisë në tremujorin e parë rol të rëndësishëm ka Acidi folik, me këtë rast kemi marrë këtë përgjigje: te rastet me Blighted ovum 11 shtatzëna kishin marrë Acid folik, kurse 5 nuk kishin marrë.Te rastet me Missed abortion 29 kishin marrë këtë preparat, por 15 e mohonin këtë.



Grafikoni 1.Përgjigjet e të anketuarave me Blighted ovum në lidhje me marrje të Acidit folik



Grafikoni 2.Përgjigjet e të anketuarave me Missed abortion në lidhje me marrje të Acidit folik

Një prej parametrave të rëndësishëm në mbrojtjen antenatale është edhe arsimimi i shtatzënave, me këtë rast nga anketimet me këto shtatzëna kemi arritur me të dhënat se vetëm 6.25% të atyre që ishin diagnostikuar me Blighted ovum, gjegjësisht 6.82% me Missed abortion kishin të kryer fakultetin.

Tabela 4.Niveli i shkollimit të shtatzënave

Blighted ovum			Missed abortion		
Niveli i shkollimit	Numri i shtatzënave	%	Niveli i shkollimit	Numri i shtatzënave	%
Shkolla fillore	7	43.75	Shkolla fillore	18	40.90
Shkolla e mesme	8	50	Shkolla e mesme	23	52.28
Fakultet	1	6.25	Fakultet	3	6.82
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>100.0</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>

Pasi që në mesin e shkaktarëve të këtyre patologjive rol të madh kanë edhe infeksionet në tremujorin e parë të shtatzanive, në pyetjen a kanë bërë strisho vaginale dhe cervikale gjatë shtatzanisë, te rastet me Blighted ovum kemi marrë këtë përgjigje: asnjë shtatzënë nuk kishte bërë strisho, kurse te rastet me Missed abortion vetëm një kishte bërë strisho.

Tabela 5. Përgjigjet e shtatzënave që kishin bërë strisho vaginale dhe cervikale


Blighted ovum		Missed abortion	
Po	Numri i shtatzënave	Po	Numri i shtatzënave
	0		1
Jo	Numri i shtatzënave	Jo	Numri i shtatzënave
	16		43
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>

Konsiderohet që një nga infeksionet e shpeshta janë virozat e ndryshme, për këtë arsye në pyetjen: A kanë qenë të sëmura gjatë shtatzënisë? Kemi fituar këto përgjigje: te rastet me Blighted ovum 6 shtatzëna kanë qenë të sëmura nga virusa, kurse 10 të tjera e mohojnë këtë. Te raste me Missed abortion 22 shtatzëna ishin të sëmura, 24 shtatzëna e mohojnë këtë.


Tabela 6. Përgjigjet e shtatzënave që ishin të sëmura nga virusa gjatë shtatzanisë

Blighted ovum			Missed abortion		
Po	Numri i shtatzënave	%	Po	Numri i shtatzënave	%
	6	37.5		20	45.45
Jo	Numri i shtatzënave	%	Jo	Numri i shtatzënave	%
	10	62.5		24	54.54
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>100.0</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>	<b>100.0</b>

Një dukuri që ka shumë efekte patologjike në shtazani është duhanpirja gjatë shtatzënisë, për këtë arsye shtatzënat janë anketuar edhe për këtë dukuri negative. Me këtë rast kemi marrë këto përgjigje: te rastet me Blighted ovum 37.5% kishin konsumuar duhan gjatë shtatzënisë, kurse 62.5% jo, te rastet me Missed abortion 25% kishin konsumuar duhan gjatë shtatzënisë, kurse 75% e mohojnë një dukuri të tillë.



Grafikoni 3. Përgjigjet e shtatzënave me Blighted ovum për duhanpirje



Grafikoni 4. Përgjigjet e shtatzënave me Missed abortion për duhanpirje

Pasi që një prej qëllimeve të këtij punimi ishte identifikimi i trajtimit më të mirë të këtyre shtatzënave, ato u anketuan se si ishin trajtuar në këtë spital. Me këtë rast fituam këto përgjigje: te rastet me Blighted ovum 11 shtatzëna ishin trajtuar vetëm me Misoprostol tab, kurse 5 me Misoprostol tabl. dhe Revizion instrumental të kavitetit të mitres. Te shtatzënat me Missed abortion 36 ishin trajtuar vetëm me Misoprostol tab, kurse 8 me Misoprostol tab. dhe revizion instrumental të kavitetit të mitres.

Tabela 7. Trajtimi i shtatzënave me Misoprostol tableta dhe RCUI



Blighted ovum			Missed abortion		
Misoprostol	Numri i shtatzënave	%	Misoprostol	Numri i shtatzënave	%
	11	68.75		36	81.81
Misoprostol+RCUI	Numri i shtatzënave	%	Misoprostol+RCUI	Numri i shtatzënave	%
	5	31.25		8	18.18
Gjithsej	16	100.0	Gjithsej	44	100.0

RCUI=Revizioni instrumental i kavitetit të mitres.

## DISKUTIMI

Diagnostikimi me kohë i këtyre patologjive, është me dobi të shumëfishtë për shtatzënë, personelin shëndetësor, por edhe shoqërinë në përgjithësi, pasi që në këto raste menaxhimi do të jetë më efikas. Ekzistojnë tri opsione për trajtimin e këtyre patologjive:

- 1.Menaxhimi i pritjes.
- 2.Menaxhimi medikamentoz
- 3.Menaxhimi kirurgjik(6)

Menaxhimi i pritjes konsiston në përfundimin spontan të shtatzënisë, kjo mund të zgjatë disa ditë dhe javë. Në këtë rast duhet theksuar se mbajtja e frytit të vdekur te shtatzaninë më të vjetra se 12 javë mund të shkakton çrregullime të rënda të koagulimit të gjakut-DIK (Koagulimi intravaskular i diseminuar) si pasojë e resorbimit të fermenteve proteolitike. Për këtë arsye pas diagnostikimit të Missed abortion është e nevojshme përcaktimi i kohës së gjakderdhjes, kohës së koagulimit dhe vlerat e fibrinogjenit në gjakun e shtatzënës dhe pastaj evakuimi i frytit të vdekur bëhet pasi ti kemi vlerat e fibrinogjenit mbi 1g/L. Nëse vlerat e fibrinogjenit janë më të ulta, atëherë së pari këto vlera duhet të normalizohen duke dhënë parenteral fibrinogjen ose heparinë i cili ndërpret procesin e DIK ut(7).

Menaxhimi medikamentoz konsiston në dhënien e Misoprostol tab. Në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt shtatzënave me Missed abortion nën 12 javë të shtatzënisë i është ordinaruar 1x800 mcg tab.Misoprostol peros, çdo 12 orë, kurse ato që kanë pas mbi 12 javë të shtatzënisë 1x400 mcg tab.Misoprostol peros çdo 4 orë. Dhënja e këtij medikamenti në këtë Spital bëhet vetëm në mënyrën peros për këto raste sipas protokollit të brendshëm të këtij institucioni. Nga 44 shtatzëna të takuara me këtë patologji në periudhën e lartcekur, 81.8% e kanë përfunduar shtatzëninë vetëm me medikamente, kurse në 18.1% personeli shëndetësor është detyruar të bëjë menaxhimin kirurgjik, gjegjësisht revizionin instrumental të kavitetit të mitres. Te rastet ku nuk ka pas sukses menaxhimi medikamentoz, pas 24 orëve

është bërë menaxhimi kirurgjik, gjegjësisht është bërë revizioni instrumental i kavitetit të mitres. Nga të dhënat e lartcekura, mund të konstatojmë se menaxhimi medikamentoz me Misoprostol tab.është shumë efikas në trajtimin e këtyre patologjive.

Menaxhimi kirurgjik konsiston në dilatimin e qafës së mitres dhe pastaj evakuimin e frytit të vdekur. Kjo formë e trajtimit është e dhimbshme, e kushtueshme dhe me shumë rreziqe.

Nga të dhënat e lartcekura konstatojmë se 31.25% e këtyre shtatzënave me Blighted ovum e kishin shtatzëninë e parë, kurse te ato me Missed abortion shumica e tyre, gjegjësisht 31,81% e kishin shtatzëninë e tretë, shumica e të dy grupeve të këtyre shtatzënave kishin marrë Acid folik, në anën tjetër veset e këqia, si duhanpirja ishte prezente në 37.5% të rasteve me Blighted ovum, gjegjësisht në 25% të rasteve me Missed abortion.Vetëm 37.5% të rasteve me Blighted ovum deklaruan se ishin të atakuara nga virozat e ndryshme gjatë kësaj periudhe të shtatzënisë, por kjo përqindje ishte shumë më e theksuar te rastet me Missed abortion ku arriti shifren në 45.4%. Një dukuri negative që bie në sy është fakti se nga 60 shtatzënat e anketuara, vetën njëra deklaroi se ka bërë strisho vaginale dhe cervikale gjatë shtatzënisë. Ky është një indikator që tregon për nivelin e arsimit shëndetësor të kësaj popullate, por njëherit tregon edhe përkushtimin e ulët të profesionistëve shëndetësor për zvogëlimin e këtyre patologjive. Asnjëra nga këto paciente nuk kishin bërë analiza histopatologjike dhe gjenetike pasi që në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt nuk ekziston shërbimi për kryerjen e analizave histopatologjike, si pasojë e kësaj është e pamundur të bëhet diagnostikimi i saktë i shkakut të këtyre patologjive.

## PËRFUNDIMI

Gjatë periudhës 28.02.2017 deri me 25.5.2018 janë anketuar gjithsej 60 shtatzëna.

Me Blighted ovum ishin 26.6%.

Me Missed abortion ishin 73.4%

Me Blighted ovum më shumë ishin ato që kishin shtatzaninë e parë, gjegjësisht 31.25%

Ato që kishin Missed abortion , më shumë ishin në shtatzaninë e tretë, gjegjësisht 31.81

Nga këto shtatzëna të anketuara, 6.25% kishin të kryer fakultetin (rastet me Blighted ovum) kurse te ato me Missed abortion kjo shifer ishte 6.82%.

31.25% të atyre me Blighted ovum nuk kishin marrë Acid folik, kurse ato me Missed abortion ishin 34.10% që e mohonin marrjen e këtij preparati shumë të rëndësishëm gjatë tremujorit të parë të shtazanisë.

Nga ky numër i të anketuarave(60), vetëm njëra gjatë shtazënisë kishte bërë strisho vaginale

dhe cervikale.

37.5% të shtazënave me Blighted ovum ishin të atakuara nga virozat, kurse te ato me Missed abortion kjo shifër arrinte në 45.4%.

Asnjë prej këtyre shtazënave të anketuara nuk kishin bërë analiza histopatologjike, pasi që në spitalin e lartcekur nuk ekziston shërbimi për kryerjen e këtyre analizave.

Duhanpirse ishin 37.5% të shtazënave me Blighted ovum, gjegjësisht 25% të atyre me Missed abortion.

Me Misoprostol tab.ishin trajtuar dhe përfunduar 68.75% të shtazanive me Blighted ovum, kurse te ato me Missed abortion arrinte shifren 81.81%.

## REFERENCAT

- Gliozheni O.dhe të tjerë,Obstetrika-Neonatologjia,Tiranë:T oena,2001,f.3
- Šimunić V.dhe të tjerë,Ginekologija,Zagreb:Naklada LJE-VAK d.o.o,2001,f.181
- Kim Mackenzie-Morris."What is a blighted ovum?".Ba-bycentre.co.uk. Retrieved 19 December 2013.
- Zeqiri F,Paçarada M et al:Missed abortion and application of misoprostol.Med Arh. 64(3): 151-3,2010
- Habek D,Ginekologija i Porodnistvo,Zagreb:Medicinska naklada,2013,f.192-195
- Nathan D.Fox: Managing a Missed abortion, New York Best Doctors ,Edition September 7,2016
- Dinulović D.Savremena Ginekologija,Beograd:Apollo Graphic Production,2006,f.550
- Maconochie N.Doyle P,et al:Risk factors for first trimester miscarriage-Results from a UK- population-based case-control study.BJOG 114:170,2007
- Trinder J,Brocklehursts P,Porter R,et al:Management of mis carriage:expectant,medical,or surgical? Results of randomised controlled trial(miscarriage treatment(MIST) trial. BMJ 332:1235,2006
- American College of Obstetrcians and Gynecologist:Medical management of abortion. Prac-tice Bulletin N.67 October 2005
- Cuningham et al.Wiliams Obstetrics,New York:McGraw Hill,2010
- Blohm F,Friden BE,Milson I,et al: A randomized double blind trial comparing misoprostol or placebo in the management of early miscarriage.BJOG 112:1090,2005
- Blohm F,Friden B,Platz-Cristensen JJ et al:Expectant man-agement of first trimester miscarriage in cinical prac-tice.Acta Obstet Gynecol Scand 82:654,2003
- Creinin MD,Huang X,Westhoff C,et al:Factors related to succesfull misoprostol treatment for early falure. Obstet Gynecol 107:901,2006
- Luisse C,Jermy K,May C,et al:Outcome of expect-ant management of spontaneous first trimester miscarriage:Observational study.BMJ 324:873,2002
- Maclsaac L,Derney P:Early surgical abortion:An alterna-tive to and backup for medical abortion.Am J Obstet Gynecol 185: S76,2000
- Ngoc NT,Blum J,Westheimer E,et al:Medical treatment of missed abortion using misoprostol.Int J Gynecol Obstet 87:138,2004
- Paul ME,Mitchel CM,Rogers AJ,et al:Early surgical abortion.Efficacy and safety. Am J Obstet Gynecol 187:407,2002
- Stephenson MD:Management of recurrent early pregnan-cy loss.J Reprod Med 51:303,2006

# СТАВОВИ И ИСКУСТВА НА ДОКТОРИТЕ ПО ДЕНТАЛНА МЕДИЦИНА ЗА ДЕНТАЛНИОТ ТУРИЗАМ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Наташа Павлоска<sup>1</sup>, Весна Велиќ Стефановска<sup>1</sup>, Киро Ивановски<sup>2</sup>, Влатко Коколански<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Институт за епидемиологија и биостатистика со медицинска информатика,  
Медицински факултет, Универзитет “Св.Кирил и Методиј”, Скопје

<sup>2</sup>Катедра за болести на устата и пародонтот, Стоматолошки факултет, Скопје Универзитет “Св. Кирил и Методиј”, Скопје

Medicus 2018, Vol. 23 (3): 271-277

## АПСТРАКТ

**Вовед:** Денталниот туризам е дефиниран како чин на патување во туѓа држава со цел да се добие стоматолошки третман. Тој претставува подмножество на медицинскиот туризам. Некои земји се рецептивни, а некои емитивни за денталниот туризам. Во првите доаѓаат државјани на вторите, заради добивање стоматолошки услуги кои се редовно повеќекратно поскапи во нивната матична земја. **Цел:** Студијата има за цел да укаже на ставовите и искуствата на докторите по дентална медицина за денталниот туризам во Р.Македонија и евентуалната разлика помеѓу половите во однос на некои од нив. **Материјал и метод:** Во периодот од февруари до март во 2018 година беше спроведена квантитативна аналитичка студија на пресек (cross sectional study). Испитаниците во примерокот беа селектирани по метод на прост случаен примерок со почитување на однапред утврден инклузиони и ексклузиони критериуми. Примерокот го сочинуваа доктори на по дентална медицина, кои по електронски пат беа контактирани и кои прифатиле да учествуваат во истражувањето. **Резултати:** Во истражувањето учествуваа 176 доктори по дентална медицина, со здрава стапка на повратен одговор од 71%. За  $p > 0,05$ , немаше сигнификатна разлика во просечната возраст на испитаниците од двата пола. Не беше утврдена сигнификантна разлика ( $p > 0,05$ ) помеѓу половите во однос на искуството за работа со пациенти од странство како и ставовите за мотивирачките фактори за доаѓање на овие пациенти. Сигнификантно повеќе доктори по дентална медицина сметаа дека ризикот за компликација кај пациентите од странство изнесува 1-2%, споредено со оние кои сметаа дека овој ризик е повисок (Difference test: Difference 69,30% [(60,7-75,8) CI 95%]; Chisquare=168,57; df=1;  $p=0,0001$ ). **Заклучок:** Значаен дел од докторите по дентална медицина имаат повеќе годишно искуство во лекувањето на странски пациенти што укажува дека во Р.Македонија постои дентален туризам. Најчесто, уделот на странците во вкупниот број на пациенти како и во вкупниот приход на ординациите не надминува 20%. Неопходни се натамошни истражувања на оваа тема.

**Клучни зборови:** дентален туризам, пациент, дентален турист, стоматолошки третман

## Вовед

Медицинскиот туризам претставува сегмент на здравствениот туризам. Според СЗО, медицински туристи се луѓето кои патуваат преку граница, од една во друга земја, заради некаков медицински третман. Најчесто барани здравствени услуги во друга држава се стоматолошките третмани, естетската хирургија, елективната хирургија и лекување на стерилитет (1).

Резолуцијата 28Н-2008 на ADA (American Dental Association), го дефинира денталниот туризам, како чин на патување во туѓа држава со цел да се добие стоматолошки третман (2). Денталниот туризам се смета за подмножество на медицинскиот туризам. Се

проценува дека застапеноста на денталниот туризам во целокупниот светски здравствен туризам изнесува околу 40% (3). Популарноста на денталниот туризам се должи во голем дел на фактот, дека третманот и времето на опоравување на пациентот е релативно кратко, дозволувајќи му на странскиот пациент, потенцијалниот турист, време и енергија за одмор (4).

Според многу автори, денталниот туризам претставува уште еден класичен пример за глобализација. Сепак, мобилноста на денталните туристи е повеќе регионална, отколку глобална (5). Согласно улогата во рамките на денталниот туризам, земјите може да бидат рецептивни и емитивни. Во првите доаѓаат

државјани на вторите, заради добивање стоматолошки услуги кои се редовно повеќекратно попкапи во нивната матична земја (6). Денталните туристи најчесто доаѓаат од развиените земји на западниот свет. Пациентите од Западна Европа, со потреба за дентални интервенции, најмногу патуваат во Унгарија како лидер во европскиот регион. На американскиот континент, центри за дентален туризам се Мексико и Костарика. Во Азија водечка медицинско-туристичка сила е Индија, која е и светски супериорна за овој проблем, а по неа со своите активности на ова поле се истакнува Тајланд.

По овие земји конкуритивно следуваат и Полска, Турција, Романија, и Хрватска (7).

Главни причини за медицински а со тоа и на дентален туризам внатре во Европската Унија се: а) пониската цена; б) пократкото време на чекање; и в) довербата во стручноста и здравствениот систем (8). На американскиот континент, факторите што го одредуваат денталниот туризам се: а) однос цена/услуга; б) капацитет за давање на услуги; в) технологија; г) време на чекање; д) доверба во здравствен систем и е) урбан имиџ (9). Сите овие чинители може да бидат класифицирани и како push (потискувачки) и pull (привлекувачки) фактори, односно фактори кои го одбиваат или го привлекуваат пациентот (6). Во прилог на ова, push фактори се високите цени на услугите во сопствената земја, немање здравствено осигурување како и јазичната бариера меѓу имигрантите и домашните стоматолози. Pull фактори се квалитетот на услугата во туѓата земја, краткото време на чекање, поевтините цени, познавањето на заеднички јазик, условите за одмор, политичката клима и друго (10).

Денталниот туризам за разлика од медицинскиот туризам, не е секогаш прашање на избор, туку и на принудна околност. Недостатокот на здравствено осигурување е клучен фактор за Американците со ниски примања да се лекуваат во мексиканските погранични клиници кои нудат дентални услуги за многу поефтини цени (11). Во Европа водечки рецептивни дестинации за денталниот туризам се

Унгарија и Полска, кои заедно сочинуваат две третини од европскиот пазар (4). Според Kovacs и соработниците, на овој пазар Унгарија учествува со 39%, Полска со 32%, Шпанија со 7%, Бугарија со 7% и Турција со 15% (12).

Во Унгарија, како членка на Европската Унија, бројот

на стоматолози на 100.000 жители изнесува 66 и е помал од европскиот просек, што значи дека овој параметар не е пресуден за развој на денталниот туризам. Во Унгарија, денталниот туризам започнал со прекугранична мобилност на австриските и германските пациенти во раните деведесетти години на XX век. (12,13,14). Главниот град на оваа земја, пред се поради културно-историската атрактивност и нискобуџетните летови, успеал да стане “дентална престолнина“ на Европа (12,13). На ова се надоврзуваат и квалитетот на унгарската дентална пракса како и нискиот ризик за компликации што изнесува околу 5% и е сличен на европскиот просек. Според многу студии, задоволството на пациентите од денталниот туризам во Унгарија е големо, поради што најголемиот дел од нив би дошле повторно со иста цел (13).

Во Хрватска денталниот туризам е најзастапен вид на медицински туризам (15). Одредени автори ја посочуваат и Романија како дестинација за денталниот туризам на пациенти од побогатите европски држави, особено од Италија (16).

Денталниот туризам носи со себе многу предизвици како што е одговорност на давателите на услуги за постојано подигнување на нивото на стручна подготвеност, како и минимизирање на ризикот од крвно преносливи болести (17). Етичките аспекти на денталниот туризам се однесуваат на автономијата во изборот на давател на услуга, гаранција за безбедност на пациентот, континуитет на услугите, информирана согласност, добра комуникација лекар-пациент и друго (18).

Истражувањето има за цел да укаже на евентуалната разлика помеѓу половите на докторите по стоматологија во однос на ставовите и искуствата за денталниот туризам во Р.Македонија.

### Материјал и методи

Истражувањето преставува квантитативна студија на пресек (cross sectional study) спроведена во периодот од февруари до март во 2018 година. Испитаниците во примерокот се селектирани по метод на прост случаен примерок со почитување на однапред утврден инклузионен критериум како активна работа во сопствена или туѓа ординација на територијата на државата и искуство во работа со лица од странство. Примерокот го сочинуваа 176 доктори по стоматологија кои по електронски пат беа контактирани и кои

прифатија да учествуваат во истражувањето. Стапката на повратен одговор на контактираните испитаници изнесуваше 71%.

